



Përtej Gjallës



DILEMAT E NJË MATURANTI



**Kur'ani,
Besim dhe
Enciklopedi në
duart tona**



**Përse vajzë
apo djalë?**



**Himn për
mësuesin**

Ka thënë Ibnu'l Kajjimi:

Katër gjëra shkatërrojnë trupin:
brença, pikëllimi, uria dhe pagjumësia.

Katër gjëra zbehin fytyrën:
Gënjeshtria, turpi i pakët, pyetja pa patur dituri fare dhe marrëzitë e shumta.

Katër gjëra shndrisin fytyrën:
devotshmëria, burrëria, përmbushja e premtimit dhe bujaria.

Katër gjëra sjellin urrejtjen dhe mërinë:
Mendjemadhësia, zilia, gënjeshtria dhe bartja e sjalëve.

Katër gjëra sjellin rrizkun:
Falja natën, istigfari i shumtë gjatë mesnatës, bërja shprehi e dhënies së lëmoshës dhe përmendja e Allahut në fillim dhe mbarim të ditës.

Katër gjëra pengojnë rrizkun:
Gjumi në mëngjes, namazi i pakët, përtacia dhe tradhtia.

Pese njihen me pese
Pema me frutat e saja, gruaja njihet kur burri të varfërohet, shoku në ditë të vështira, besimtari në sprovim dhe bujari në kohëra krizash.

Pese mbysin pese
Shpifja të vërtetën, pasuria të metat, devotshmëria e pshin, përmendja lëmoshën dhe nevoja (varfëria) parimet.

Pese sjellin lunturi
Fëmija i ndershëm, gruaja e ndershme, shoku i mirë, besimtari bamirës dhe dietari i zgjuar.

Pese zbukurohen me pese
Shëndeti me jete të mirë, udhëtimi me shoqëri të mirë, bukuria me moral të mirë, gjumi pa probleme paraprake dhe nata me përmendjen e Allahut.

Pese sjellin pese
Istigfari sjell rrizkun, ulja e shikimit sjell virtytin, turpi sjell të mirat, të folurit e bute sjell kërkuesin dhe hidhërimin sjell keqardhjen.

Pese largojnë pese
Te folurit e bute hidhërimin, istiadheja (eudhu bil-lahi mine'sh shejtani'r rraxhim) largon djallin, matura largon pishmanllëkun (keqardhjen), përmbajtja nga të folurit largon gabimet dhe duaja largon caktimin e keq.
Puna më e mirë tek Zoti është ajo që është e vazhdueshme, goftë edhe e vogël.

Përmbajtja

- 4 ► **Editorial** nga A. Muja
A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë
- 6 ► **Përtej fjalës** nga Iris Maçi
Dituria është rruga e besimit
- 10 ► **Trokas** nga Entela Hidri
Himn për mësuesit
- 12 ► **Unë pyes** nga Oriola Heta (Varrosi)
Pas provimeve të maturës,
si të zgjedhim degën që bën për ne
- 14 ► **Këndvështrim** nga Armida Plumbi
Dilemat e një maturanti
- 19 ► **Para çdo diturie** nga
Kur'ani, besim dhe enciklopedi
- 23 ► **Zëri im** nga Izmina Zejnuni
Lindim të barabartë...
marrim rrugëtime të ndryshme...
- 25 ► **Zëri im** nga Brunilda Zadeja
Kur flasim për barazi
- 30 ► **Pasqyrë sociale** nga Elfa Kodra
Shoqërimi: Dëshirë apo detyrim
- 31 ► **Post Ramazan** nga Irfan Tota
Lamtumirë muaji i begatë
- 35 ► **Mesazhi në shishe** nga U. Fejzullahu
Pas një muaji provim, sa do të doja të dija notën time
- 37 ► **Seria e profetëve** nga Irfan Tota
Hudi dhe populli që u dënua nga erërat e fuqishme
- 40 ► **Më duhet ta di** nga A. Dhimo
Mënyrat për të ushqyer trurin
- 43 ► **Ajo** nga
Si ta njohim menopauzën

BASHKËPUNËTORË:

ELSA XHAI- gazetare - Kryetare e Shoq. "Gruaja në media"
SHEGA MURATI - Kryetare e Shoq. "Zëri i fëmijëve na thërret"
JULIANA AJDINI, Prof. Fakulteti Shkencave Sociale.
A. KALAJA - teolog, G. LECINI - gazetar

KËSHILLI I REDAKSISË:

ADELINA KASEMI; ERIONA KODRAGJINI; ENTELA HIDRI;
ARMIDA PLUMBI; ENKELEDA RROSHI; EDLIRA DURMISHI.

Pikpamjet e paraqitura në revistë nuk shprehin
domosdoshmërisht pikpamjet e revistës.



PËRTEJ FJALËS

Kryeredaktore:

ALBANA MUJA (CIKU)

Redaktore gjuhësore:

Prof.dr. Mimoza Gjokutaj

Recensues fetar:

AHMED KALAJA

Art grafika:

Ornela Bita

Boton:



Mirëpresim sugjerimet
tua, idetë e opinionet
pranë adresës sonë:

e-mail: pertejfjalës@gmail.com

© Të gjitha materialet e botuara
në revistë janë të rezervuara për
botuesin e "Përtej fjalës".

Nuk lejohet përdorimi, riprodhimi
apo publikimi i tyre pa lejen e
botuesit.

“A janë të barabartë
ata që dinë dhe ata që
nuk dinë?!”

Kuran



Në krijimin e pashoq të mbarë krijesave, gjejmë edhe krijimin e intervaleve kohore që na çojnë larg e na sjellin sërish ku ishim, na bëjnë më të pjekur më të zgjuar e më pas më të moshuar, por të pajtuar gjithnjë me caktimin që u shkrua për ne.

Kështu kohë pas kohe nisemi e shikojmë ku dhe përse ikin muajt apo vitet? Ndërsa në fakt ata nuk janë edhe aq të këqinj' me ne, ata kthehen sërish!

Kështu edhe muaji i rifillimit të shkollave dhe universiteteve ka trokitur .Me gjithë zhurmën që e karakterizon ditën e parë të shkollës, fillimin e atij marshi gjigand që do të ngelet gjatë gjithë kohës një stacion i rëndësishëm i jetës, sërish dita e parë- është po e para, ajo fiksohet dhe mbahet mënd.

Po nuk mjafton kjo, për të qënë një ditë që fiksohet në kujtesat tona, por na duhet po aq shumë pasimi i saj me të nxëniti e vazhdueshëm aq sa koha të na premtojë për të qënë të dobishëm për vetet tona dhe shoqërinë ku jetojmë.

Në fakt kërkimi i dijes nuk është i lidhur domosdoshmërisht me fillimin e sotëm apo të djeshëm të shkollës, ai nis që në gjenezën tonë të hershme kur nuk pati kohë të përcaktuar studimesh apo jo, ndaj edhe në shumë transmetim profetike, kur flitet për dijen,- dija, kjo fjalë përshfaqet me madhështinë e saj që na ndjek nga djepi deri në varr.

Duke qënë edhe urdhëri i parë i Zotit në Kuran dhe pararendës madje edhe i urdhëresës për besim islami dhe besimtarët i kushtuan ndër shekuj e vite, madje edhe sot rëndësi dijes.

Kështu shumë prej organizatave apo shoqatave kulturore në Tiranë, me organizimet dhe projektet e tyre kanë shtruar dhe janë munduar të vënë themelet e ringritjes së kështjellës që në fakt do duhej të kishte dija si institucion edhe pse abstrakt ,në mënyrë që ta kujtonte shpesh herë konkretësinë e saj"

Kështu si jo rrallë herë xhamia e Rrugës së Kavajës Dine Hoxha në bashkëpunim me Shoqatën „Gruaja Investim i Familjes“, pak kohë më parë, organizuan një aktivitet me rastin e përmbylljes së tre vjeçarit të parë të institutit të studenteve të qytetit të Tiranës. Jo siç ndodh gjithnjë ku formaliteti i kalon caqet e një dite përrurimi, por si asnjëherë më mirë, ky aktivitet promovoi mirësitë e

ketij Insituti që u hap jo më shumë se 3-4 vite më parë, por që mbledhi rreth tij gra dhe vajza, si studente që dinë të sfidojnë kohën me plot-pengesat e saj për të gjetur sadopak hapësirë për vetet e tyre dhe mirëedukimin e tyre nëpërmjet lëndëve sociale e fetare.

U promovuan studentet më të mira, ku po të numëroheshin ishin po aq sa studente kishte klasa, pra kur të gjitha duke pasur për qëllim shfrytëzimin total të kësaj mundësie dijeje, rezultatet ishin mahnitëse. Por si në çdo marsh jetik, hierarkia nis nga 1- shi dhe mbërrin lart e më lart në vargun pa fund numerik e hapësinor.

Kështu ajo që ra në sy atë ditë të veçantë ishte përkushtimi që kishin treguar iniciuesit e kësaj ndërmarrjeje me përgjegjësi, drejtorët dhe mbarë stafi, si edhe studentet me rradhë ,që çdo gjë të shkonte sipas linjës së urdhëruar islame. Drejtoresha e Instituti E. Kodragjini përveç fjalës së saj përshëndetëse dhe përkujtuese rreth dijes na njohu me fitueset ose studentet më të mira të këtij 3 vjeçari si edhe me të diplomuarat.

Ajo që ra në sy sërish ishte se, mes studenteve që jemi mësuar t'i njohim si studente relativisht të një moshe studentoreje, ishte edhe një nënë Lavdije Mullaxhija që u kurorëzua me çmimin e parë, "për rezultate më të mira në çdo degë dhe në çdo vit, si përfituesja më e mirë në grupin e „ pasdites“.

Ky realitet që përjetuam atje na ngazëlleu dhe na shtyu më shumë të jemi kërkuese të dijes, kur pamë se dëshira për dije kapërcente çdo moshë e pengesë ku gra besimtare me plot vullnet dhe dëshirë e besim gjen forcë e guxim që përmes impenjimesh të shumta prej nënë, bashkëshorte etj të këkrojnë dijen e dobishme, të cilën shpeshherë e justikojme se nuk gjejmë kohën për t'i kushtuar. Çmimet lakuan emra prej studenteve si M.Qoshja, studente pranë Fakultetit të Shkencave Sociale dhe E. Kodra, njëkohësiht studente në degën e Psikologjisë dhe kontribuese në dhënien e dijes pranë Institutit.

Duke uruar që çmime të tjera të vazhdojnë të nxizin në marrjen e dijes, e mbyllim këtë faqe për të hapur një tjetër në mbyllje të vitit akademik 2010-2011.

Të diplomuarat

Miranda Qoshja,
Elfa Kodra,
Anila Bafti,
Lulzime Ajvazi,
Shpresa Ajvazi,
Migena Ago,
Mirushë Vladi



“Zoti ju nxorri nga barqet e nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë. Ju dha juve dëgjimin, shikimin dhe zemrën, që ju të jeni falenderues.”

Është Zoti Ai, që i mësoi njeriut çfarë nuk dinte dhe i dhuroi atij sy, veshë, mendje, zemër që të udhëhiqet dhe të mësojë diturinë që i vlen.

Nuk ka dyshim se feja islame i ka dhënë rëndësinë më të madhe diturisë, dhe i nxit besimtarët që t'a kërkojnë atë, të përdorin mendjen e të hulumtojnë në të gjitha fushat e saj, si dhe në çdo

kohë të jetës së tyre. Feja islame tregon se dituria është themeli i një jete të mirë, bazë e zhvillimit dhe rrënjë e çdo qytetërimi dhe mjet përparimi për individë dhe popuj.

“Kërkimi i diturisë është detyrë e shenjtë për çdo musliman dhe muslimanë” - thotë profeti ynë e ndërsa në një thënie tjetër ai përsëri pohon “ Në

qoftë se një njeri mundohet të fitojë dituri, Allahu do t'ia bëjë atij rrugën më të lehtë për në Parajsë”.

Feja islame është bazuar në dituri. Mrekullia më e madhe e profetit tonë(a.s) është fjala e Zoti e shkruar, Kur'ani, që shkëlqen me dituri të lartë dhe njohuri të sakta e që nuk bien kurrë ndesh me shkencat dhe dituritë e provuara.

Është rruga simit



Feja islame na mëson që të përdorim mendjen dhe diturinë, dhe ajo e quan kërkimin e saj si një prej adhurimeve më të larta. “Dituria e paktë është më e dobishme se adhurimi i shumtë.”- thotë profeti (a.s), sepse ai që ka dituri i mëson ashtu siç duhet edhe adhurimet e tjera.

nga Iris Maçi

Por ç'është dituria dhe për çfarë shërben ajo?

Edhe ai që e lexon këtë, ka për qëllim që të përfitojë dhe të mësojë, pra të marrim dituri. Është e nevojshme të dimë se për çfarë shërbejnë gjërat që mësojmë, dhe nuk do të ishte aspak e nevojshme nëse ato do t'i mësojmë përmëndësh, sepse kjo nuk do të thotë që të dish, apo kur mëson diçka dhe nuk i

zbaton ato, atëherë ato nuk kanë më vlerë. Gjithashtu, kur kërkojmë dituri nuk është qëllimi ynë vetëm për të marrë diplomë apo dëshmi, që të mund të krenohemi para të tjerëve me letrat që kemi në duar, por sa jemi ne të aftë t'a japim këtë dituri që kemi marrë, dhe është vetëm Allahu i Lartësuar, Ai që e vlerëson diturinë tonë. E ka nga ata që nuk e njohin

Allahun dhe nuk i frikësohen Atij, e njohuritë dhe dituria që kanë, nuk u hyn në punë, sepse ai që nuk e vë në punë zemrën e tij nuk mund të marrë kurrë në zotërim diturinë e vërtetë. Dituria është në të vërtetë një *mister* dhe Allahu që është vetë i Ditur i dhuron njeriut, pjesë nga dija e Tij. Dituria është një forcë e jashtëzakonshme. Përballë

saj, as forca fizike dhe as ndonjë forcë e ndonjë natyre tjetër nuk mund t'i rezistojë. Dituria është ajo forcë që ka mundësi t'a çlirojë njeriun nga ato forca negative, që kërkojnë t'a mposhtin dhe t'a burgosin atë në dëshira të ngushta tokësore.

Pra, dituria simbolizon forcën. Mjaft bukur në Kur'anin e shenjtë tregohet për historinë e profetit Sulejman (a.s) dhe të Belkisës; *"Kush mund t'a sjellë fronin e Belkisës në 40 ditë udhë? Ndihmësi i Sulejmanit i mbushur me besim dhe dituri tha: Unë mund t'a sjell sa hap dhe mbyll sytë"*. Në këtë rast, Zoti na njeh me forcën që zotëron ai të cilit i është dhuruar dituri; *"E froni u soll sa hap dhe mbyll sytë"*. Dhe Allahu vesh me rrobën e diturisë kë të dëshirojë.

Dituria është ushqim për besimin, dhe ajo gjendet në raport të drejtë me imanin. Pra ajo dhurohet sipas imanit dhe imani dhurohet sipas shkallës së dijes. E profeti ynë (a.s) është një det i papërshkrueshëm dijes dhe një oqean i pafund imani.

Por kush është i ditur?

I ditur është ai që e njeh dhe e do Zotin e tij dhe përpiqet të marrë prej dijes së Tij. Dijetar është ai që i dridhet çdo gjymtyrë e trupit, kur përmend emrin e Allahut. *A nuk thuhet në Kur'an se ata që i frikësohen më shumë Allahut janë dijetarët?*

Endërsa profeti na kaporositur që t'u drejtohem i atyre, e se të tillë të ditur duhen kërkuar,

përndryshe dikush që nuk e njeh e nuk gëzon dashuri për Allahun, nuk gëzon cilësinë e të qenurit i ditur. Sepse ai që ka dije, ka edhe mundësinë të ndalë forcat e të keqes, e mundet t'i thotë egos së vet *"Nda!"*, nuk u shkon pas dëshirave të paligjshme dhe nuk i shërben të keqes. "Një i ditur është më i rrezikshëm për shejtanin se sa 1000 adhures."- thuhet në një hadith të profetit (a.s).

Dituria është rruga e besimit.

Njeriu patjetër duhet të kërkojë mbi njohjen e argumenteve të besimit dhe dokumentave të tij, sepse Allahu i Madhëruar e ka bërë diturinë, rrugë të besimit në Zot duke thënë: *"Atëherë dije se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut"* (Muhamed/19). Apo kur thotë: *"A është i njejtë ai që di, se ajo që t'u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, nga ai që është i verbër (nuk di)? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën."* (Rrad/19). Pra, synimi kryesor i fitimit të diturisë është afrimi me Zotin.

Dituria nuk kërkohet vetëm për kënaqësinë e mendjes e të shqisave, por ajo duhet të lidhet ngushtë me vlerat dhe synimet përkatëse. Një prej qëllimeve të përvetësimit të diturisë, është që të sigurojë të mirat e kësaj bote, e jo ta shkatërrojë atë nëpërmjet shpërdorimit, krenarisë, paturpësisë e mëndjemadhësisë, në

përpjekje të përmirësimit të kushteve materiale të jetesës. Një tjetër synim është përhapja e lirisë, nderit, të vërtetës e të drejtësisë.

Bashkërendimi i diturisë, fuqisë, krenarisë e paturpësisë, çon në tirani dhe paturpësi, ndërsa bashkërendimi i diturisë, fuqisë dhe mirësisë, çon në drejtësi e liri.

Dihet që dituria është e pafund dhe fushat për studim dhe hulumtim janë të pakufishme. E njeriu që t'a vë në shërbim këtë dituri duhet të dijë t'a kërkojë e më pas t'a përvetësojë atë. Prandaj diturinë e ndajmë në dy grupe:

- Dituri themelore ose jetike, dhe kjo është dituria që duhet përvetësuar prej secilit, që me anë të saj të jetë në gjendje për të plotësuar misionin e tij si njeri, e për të kryer detyrat si musliman.

- Dituria mjeshtërore, kjo i nevojitet njeriut për të siguruar jetesën, e kjo bëhet nëpërmjet aftësive vetjake dhe interesave dhe nevojave të bashkësisë.

Që të fitosh dituri duhet të mësosh me themel. Njeriu i vërtetë kurë nuk mund t'i lejojë vetes që të mbetet gjysmak. Të dish do të thotë që edhe punën ta kryesh mirë, që prej saj të marrësh jo vetëm rezultate, por të fitosh edhe kënaqësi. A nuk thotë dhe populli që edhe për të ngulur një gozhdë duhet dituri, pra të dish.

Ai popull që nuk ka njohje e dituri prodhuese në çdo fushë të jetës, nuk mund të zëjë vend në popujt e qytetëruar, sepse konkurrenca në mes popujve është shumë e madhe dhe i bën ata popuj që nuk i japin rëndësi diturisë, të mbesin prapa, të



shfrytëzohen e të varfërohen. Islami i fton besimtarët që të konkurojnë në çdo fushë të diturisë në mënyrë që të mos merren nëpër këmbë e të humbin. Allahu me madhështinë e Tij i nxiti ata që të studiojnë, të hulumtojnë e të nxjerrin thesaret e tyre, për t'i përdorur për mbarvajtjen e tyre për të cilën janë krijuar. "A nuk vështroni se Zoti ka bërë që të shfrytëzoni ju gjithçka është në qiell dhe në tokë?" apo ku thotë "Kemi zbritur hekurin që ka forcë të madhe dhe dobira të shumta për njerëzit." etj...

Feja islame na mëson që të përdorim mendjen dhe diturinë, dhe ajo e quan kërkimin e saj si një prej adhurimeve më të larta. "Dituria e paktë është më e dobishme se adhurimi i shumtë."- thotë profeti (a.s), sepse ai që ka dituri i mëson ashtu siç duhet edhe adhurimet e tjera.

Islami porositi për të mësuar çdo shkencë, që ka të bëjë me krijimin e krijesave e fenomeneve të ndryshme të natyrës, e kjo duket mjaft qartë në ajetet kur'anore

"Vallë, a nuk shikojnë ata se si është krijuar deveja, dhe si është ngritur qielli, dhe si janë vendosur malet, dhe si është shtrirë toka?", e për t'i kuptuar këto duhet t'i mësojnë të gjitha shkencat pa asnjë dallim.

Dituria është një thesar.

Thesari i madh i diturisë islame mbeti i pandryshuar, por me kalimin e kohës ajo ka nevojë për çelësa të rinj, për t'a hapur dhe për t'u futur në të. Çdo brez bën pyetje të reja, prandaj duhen edhe njerëz me njohuri të gjëra, që t'i përgjigjen me saktësi këtyre pyetjeve.

Ndërsa profeti Muhamed (a.s) e ka përkufizuar të tillë diturinë: "Mësoni dituri sepse mësimi është frikë dhe respekt ndaj Zotit, kërkimi i diturisë është adhurim, përsëritja e diturisë është lartësim i Allahut, hulumtimi i diturisë është xhihad, t'ua mëson diturinë të tjerëve është lëmoshë, sakrifikuesit e diturisë për bartësit e saj është afrim tek Allahu i Madhëruar, sepse dituria është sinonim i shenjave të së lejuarës dhe të së ndaluarës, tregues

i rrugëve të banorëve të xhenetit, dituria është zbutje e tërbimit, shoqërues gjatë udhëtimit, bashkëbisedues në vetmi, udhëzues për bollëk, dhe skamje armë kundër armikut, stoli tek të dashurit, me të Allahu lartëson disa njerëz, i bën prijës dhe pishtarë në të mirë, kështu që hapat e tyre pasohen, veprimet e tyre ndiqen dhe mendimi i tyre pranohet, melekët e synojnë shoqërimin e tyre e me fletët e tyre i lehtëtojnë dhe për ta kërkojnë falje çdo gjë, madje edhe peshqit dhe gjallesat e detit, kafshët e egra dhe të buta të tokës, kandil i dritës në errësirë, njeriu i ditur arrin pjedestalet e të zgjedhurve, gradat më të larta në këtë botë dhe në botën tjetër, analizat shkencore janë identike me agjërimin, studimin është identik me namazin, me dituri respektohet farefisi dhe përmes diturisë njihet hallalli nga harami, dituria është prijës kurse praktika e ndjek atë, ajo u jepet njerëzve të lumtur e ndërsa nga ajo privohen të humburit.



Simn



a dhe pushimet po mbarojnë dhe po lënë atë shijen e ëmbël, e cila nuk do të largohet derisa vera tjetër, me të tjera surpriza të vijë përsëri.

Mbi fronin e mendimeve të mia qëndron këmbëkryq e vetmja ide fikse: “ Sfida e një viti të ri shkollor.”Më kujtohet shtatori i fundit se si me regjistër në dorë bëja hapat e rradhës që në rrethin e dijes të përfshija sa më shumë nxënës.

Para se të hap derën e klasës, mora frymë thellë. Ishte klasa e nëntë .Më dukej vetja si studente dhe zemra më dukej sikur do të më shpërthente kraharorin.Më dukej sikur doja t'i thoja të gjithë botës se ne mësuesit edhe pse dukemi prej guri jemi qëniet më të ndjeshmë dhe më të buta. Fshihemi pas një fasade e cila ndan frikën tonë dhe emocionet që të jep sfida e një shtatori të ri. Nuk është shtatori i parë dhe nuk do të jetë i fundit por përsëri zemra ndodhet aty, pikërisht në kraharor dhe rreh më fort se kurrë.

Përpara qëndrojnë shumë palë sy të cilat në pedestal kanë vendosur sytë tanë dhe përpinë kureshtarë çdo gjest sado të pakuptimtë, për të hyrë sadopak në mendësinë tonë. Mos u shqetëso them me vete, o Mirsad, se edhe unë si ti po mundohem të të studioj dhe të hy brenda mendësisë tënde, për të qenë sa më pranë teje dhe për të gjetur mënyrën më të mirë për të të servitur dijen .

Sfida të reja na presin dhe ne që vazhdojmë të kemi ide fikse se secili nga nxënësit që kemi para nesh do të bëhet dikush në jetë.

Një zë më nxirrte shpesh nga mendimet:

- Entela, – thoshte drejtori im,- Të mirën që ju ua bëni të tjerëve sot, të shumtë do të jenë ata që do ta harrojnë nesër, por ju vazhdoni të bëni mirë, sepse çdo gjë të mirë që bëtë ishte një çështje mes jush dhe Zotit dhe jo mes jush dhe atyre që nuk e kuptuan kurrë mirësinë tuaj.

Është e vërtetë! Shumë do të harrojnë se ne nuk e kursuem veten tonë për të arritur maksimumin dhe për të qenë sa më lart në dhënie e dijes, por më mbushet kraharori me jetë kur një nxënës më thërret në rrugë dhe edhe pse është një pëllëmbë më i gjatë se unë më thërret mësuese dhe më shikon me admirim. Ky është një nga shpërblimet që nuk mund të blihet me para për një mësues edhe sikur të shpenzojnë të gjithë pasurinë e botës, sepse është një kënaqësi që vetëm ne mësuesit kemi luksin ta kemi dhe mundemi ta shijojmë.

Ky profesion i thjeshtë por shumë fisnik, gjeneron breza të ndryshëm duke filluar që nga doktorët, juristët, punëtorët, inxhinierët e deri të politikanët. Japim veten, frymën dhe shpirtin pas jush duke u shterruar fizikisht, por jo shpirtërisht.



për mësuesit

Jo kurrë shpirtërisht, sepse janë sytë tuaj rinorë që na bëjnë të ndihemi të rinj në shpirt dhe në ide.

Shpesh ka patur edhe situata të vështira në të cilat unë dilja me një mijë “përse” ende të pazgjidhura dhe vetëm pas kaq viteve kam arritur në përfundimin, se duhet një jetë e tërë për të kuptuar se nuk është e nevojshme të kuptosh gjithçka.

Disa fjalë thuhën shkujdesur, disa thuhën në vendin e gabuar, disa fjalë lëndojnë një zemër, disa thjesht u thanë e u hodhën si një trakt për të mbetur aty thellë në egon dhe në zemrën e thyer të një mësuesi, por ti kolegja ime ec përpara, sepse këto gjëra të forcojnë dhe të bëjnë të kuptosh se pa këto ti nuk do të ishe një mësuese e mirë.

Të tërë ankohemi nga ngushtësia e kohës dhe punët e shumta, por sa kohë mund të ketë një mësuese për vete kur ajo të gjithë jetën madje dhe mbasditen e saj të shtrenjtë ia fal nxënësve të saj të dashur.

Të ëndërrosh por jo si rob ëndërrimesh, ne mësuesit vdesim ëndërrimtarë duke kërkuar në çdo vit të karierrës sonë, në çdo bankë dhe në çdo fytyrë dhe duke gjetur atë nxënësin e mirë i cili na jep kënaqësinë e të qenit mësues.

O ju njerëz, nëqoftëse deri më sot na keni parë ndryshe, sot po ju themi se ne jemi i vetmi çelës që mundet t’ju fusë në oqeanin e paanë e të pafund të dijes.

Ja një shtator I ri po vjen dhe unë ia kushtoj këtë shkrim juve si jë zambak i freskët, i cili është himni i këtyre heronjve dhe heroinave .

Ata pa u ndjerë vetsakrifikohen si qeriri për të përhapur pakëz dritë mbarënjerezore.

dija mbrohet dhe me revelata hyjnore. Ajo kërkohet në të gjitha dimensionet e saj që nga djepi deri ne var.

Kur telat e jetës të këputen, kur gjaku në vena të mpikset, kur të jetë thënë shehadeti i fundit dhe fryma e fundit të ketë lënë trupin, atëherë mësuesi do të pushojë së qëni i tillë, deri atëherë vitet nuk do të jenë një barrjerë mes mësuesit dhe nxënësimit të tij, sepse ti o nxënës ishe flladi I mëngjesit, shpresa e përjetshme, ishe gëzimi I zemrës, ishe shqetësimi, i cili e ndiqte trupin si tik-taket e orës.

Edhe nëse ti heq dorë nga çdo gjë, në kujtimet e tua feminare thellë në kujtesë, fshihet një kujtim I lidhur me një mësues të dashur I cili edhe pse vitet rrodhën, I mbijetoi kohës dhe mbeti përsëri aty, brenda zemrës tënde.

PAS PROVIMEVE TË MATURËS,

UNË PYES



Pas neteve të gjata pa gjumë nën steresin se si do të dalim në provimet e maturës shtetëore, fillon një etapë akoma më e vështirë dhe vendimtare për të gjithë aspirantët për studente, si të zgjedhim degën e duhur që përshtatet se shumë me dëshirat dhe aftësitë tona.

Ja disa keshilla të cilat do t'ju ndihmojnë të bëni zgjedhjen e duhur:

Sociologe: Oriola Heta (Varosi)

HAPI I PARË:

Pyetja e parë që duhet t'i bëjmë vetes është :
Cilat janë ineteresat dhe afetësitë e mia?

Para se të vendosni për të zgjedhur, reflektoni: periudha para se të vendosni se cilën degë do të zgjidhni duhet të jetë një periudhë meditimi dhe reflektimi mbi personalitetin tuaj. Duhet t'i bëni vetes një autoanalizë të thellë por mbi të gjitha të sinqertë. Cilat janë gjërat që më pëlqen të bëj? Cilat janë pasionet e mia? Cilat janë gjërat që bëj më mirë dhe në të cilat kam pasur sukses? Cilat janë aftësitë e mia më të mira?

SI TE ZGJEDHIM DEGËN QË BËN PËR NE?

HAPI I DYTË:

Të bësh një analizë të tillë, të plotë mbi veten, nuk është e lehtë. Për t'i lehtësuar gjërat na vjen në ndihmë eksperiencia e viteve të shkollës së gjimnazit. Dhe ketu i bëjmë vetes pyetjen: Cilat kanë qenë lëndët e preferuara gjatë shkollës? Në cilat lëndë kam marrë gjithmonë notën maksimale? Kam qenë më i prirur në lëndët shoqërore apo ato shkencore? Duke i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve do të ngushtojmë rrethin e alternativave dhe në këtë mënyrë do ta kemi më të lehtë për të zgjedhur rrugën e duhur.

HAPI I TRETË:

Pas analizës që i bëmë vetes kalojmë në një tjetër hap i cili është gjithashtu i rëndësishëm. Provojmë tani të vihemi përballë disa prej profesioneve hipotetike: dhe pyetjet vazhdojnë.....në cilin profesion do të ndjehem vetvetja? Si mjek, gjithmonë në shërbim të të tjerëve edhe në orët e natës??? Si gjykatës, avokat, në shërbim të së drejtës? Si drejtues? Si psikolog, ekonomist apo informaticien? Këto janë disa nga profesionet të cilat janë të njohura dhe të pëlqyera nga pjesa më e madhe e maturantëve. Por është mirë që të gjithë maturantët të marrin informacion të detajuar për profesionet e reja të cilat kërkohen edhe nga tregu i punës. Nisur nga kjo gjë është mirë që të bëni një ballafaqim të preferencave që ju keni në zgjedhjen e profesionit dhe realitetit dmth cilat janë ofertat e tregut për punë. Cilat janë profesionet më të kërkuara sot në tregun e punës dhe sigurisht më të paguarat.?

Kjo gjë do të na mundësojë të bëjmë një zgjedhje sa më afër realitetit. Të kemi një profesion që na sjell kënaqësi shpirtërore por edhe të mira materiale, që na siguron një jetesë më cilësore. Rrezja e zgjedhjeve do të ngushtohet akoma me shumë pas këtij ballafaqimi.

HAPI I KATËRT:

Se fundi duhet të vizitoni të gjitha univeristet në "Ditët e hapura" që ato organizojnë për të parë nga afër se çfarë ndodh. Për të mbledhur më shumë informacion. Mos neglizhoni asnjëherë edhe bisedat me prinderit tuaj ose persona të tjerë të cilët kanë qenë të suksesshëm në zgjedhjen e profesionit të tyre.

Në jetën e përditshme njeriu ndërkëmben mendime dhe opinione të ndryshme për probleme të caktuara shoqërore, sociale, politike. Shpesh këto nxitje të jashtme bëhen pjesë e vendimeve të tij gjatë aktivitetit jetësor dhe shtysë në zhvillimin e mëvonshëm të veprimtarisë së individit në udhëkryq. Njeriut i duhet të vendosë në një moshë të papërshtatshme për vendimet më të rëndësishme, të cilat kanë një ndikim jo të vogël në të ardhmen e tij. Në zgjedhjen e rrugës së jetës maturantëve u duhet të bëjnë disa llogaritje gjakftohta, për të shmangur dilemat dhe peshën e fajit, i cili lidhet më pas me fatin individual të secilit të diplomuar. Sipas nenit 18 të Kushtetutës, “nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit”.

DILEMAT E NJE MATURANTI



Natyrisht, liria e zgjedhjes do të jetë vendimtare, por shpeshherë në këtë zgjedhje ndikojnë edhe faktorë të tjerë ekonomikë, socialë, shoqërorë e familjarë. Përveç këtyre faktorëve, rol parësor në zgjedhjen e rrugës së jetës, duke u mbështetur në Sistemin Meritë – Preferencë, duhet të luajë “Këshillimi i karrierës”.

“Këshillimi i karrierës” ndihmon maturantët, me qëllim që ata të bëjnë zgjedhjen e duhur. Është e rëndësishme të kuptojmë misionin, strategjinë e planifikimin e këtyre këshillave, që në ditët e sotme kanë një mision të vështirë, por pak punohet për arritjen e standardeve dhe cilësinë e punës së tyre, e cila në të shumtën e rasteve vlerësohet pas disa vitesh. Mungesa e strategjive të planifikimit arsimor dhe bashkërendimit me partnerët përkatës e bën formale ekzistencën e këtyre këshillave. Nëse bashkëpunimi midis Ministrisë së Arsimit, universiteteve dhe shkollave të mesme do të jetë frytdhënës, atëherë misioni i këtyre këshillave do të jetë i suksesshëm. Kandidati që duhet të bëjë zgjedhjen më të rëndësishme të jetës së tij, duhet të informohet për cilësinë dhe programet universitare që u afrohet këtyre kandidatëve. Ministria e Arsimit ka publikuar listën e universiteteve të akredituara, tek e cila mund të mbështetet çdo kandidat maturant. Por, a është ky një kusht i mjaftueshëm? Nëse reforma e Maturës Shtetërore (Meritë – Preferencë) ka 3 vjet që aplikohet në arsimin parauniversitar, do të ishte e domosdoshme që mes publikimeve të ndryshme të realizoheshin studime statistikore se në ç’masë kjo preferencë e kandidatit ka qenë e mirëmenduar. Pra, a mjafton vetëm dëshira e pasioni për fusha të veçanta apo kandidatët duhet të mbështeten edhe në të dhëna e tregues të tjerë. Kjo do të integronte punën e shumë instituteve të tjera, pasi nuk besojmë se kemi të dhëna të sakta se sa për qind e studentëve të diplomuar punësohen e sa për qind e gjejnë veten në profesionet e përzgjedhura.

Nëse do të përpiqemi të kuptojmë karakteristikat moshore dhe psikologjinë e moshës rinore, të bie në sy ndarja e të rinjve në dy grupe. Përpara se të vendosin se në cilin universitet do të studiojnë, të rinjtë më parë duhet të vendosin nëse

do të studiojnë brenda kufijve të Shqipërisë apo jashtë këtyre kufijve (në Perëndim). Secili nga ne, qoftë prindërit e të rinjtë, e kuptojnë se ky vendim i rëndësishëm, që më pas do të ndryshojë jetën e të riut, nuk mund të merret i vetëm e pa përkrahjen financiare, morale të familjes, e cila detyrimisht paguan koston financiare të këtyre studimeve, si jashtë shtetit, ashtu edhe brenda tij. Nuk po diskutojmë këtu për familjet e emigrantëve, të cilët në shumicën e rasteve i vazhdojnë ciklet e studimit aty ku ka emigruar familja.

Maturantët duhet të jenë të mirinformuar për politikën e punësimit si dhe perspektivën e profesioneve të zgjedhura prej tyre institucionalisht. Për këtë “Këshilli i karrierës” duhet të jetë i informuar ose të përfshijë në organizimin e tij edhe specialistë të politikave të punësimit. Duhet të bëhen të ditura risqet e punësimit, pritshmëria dhe zhvillimet profesionale të viteve të fundit, mes statistikave të studiuara imtësisht. Duke u mbështetur në tregun e punës e të paktën në kërkesat e ndryshme të punësimit në shtypin e përditshëm apo aplikimet online të bëjnë përshtypje kërkesa të tilla: Kushtet e aplikimit: Të ketë mbaruar doktoraturë në vendet perëndimore (përfshihen automatikisht doktoraturat e Universitetit të Tiranës).

Sipas nenit 20 të Kushtetutës, “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”. Mendojmë se në këtë zgjedhje të vështirë gjithsecili duhet të jetë i përgatitur për dhënien e shanseve të barabarta në fillim të procesit të shkollimit dhe punësimit. Askush nuk mund të përjashtohet automatikisht nga procesi, pa hartuar më parë një strategji të mbështetur në kritere e standarde të matshme institucionale.

“Këshilli i karrierës” do të kryente funksionin e tij duke ndërtuar grupe mbështetëse ose bashkëpunëtorë të këtyre këshillave, ku të përfshihen mësues, psikologë, sociologë, ekonomistë, juristë dhe të hartohen projekte, të cilat do të jenë partnerët kryesorë të kandidatëve në përzgjedhjen e duhur për rrugën e jetës. Institucionet përkatëse mund të shpallin e ftojnë specialistë për

hartimin e projekteve të caktuara për funksionimin e mirë të këtyre këshillave. Domosdoshmërisht, ky këshill nuk mund të kryejë funksionin e tij pa mbështetjen e këshillit të mësuesve, drejtorive arsimore, si dhe organeve të pushtetit lokal, të cilët mund të mbështetin edhe financiarisht realizimin e projekteve rajonale.

UNIVERSITET Publik APO Privat



Në shekullin e XVII-të, Shekspiri zgjodhi personazhin e tij më tragjik, Hamletin, për të shprehur dilemën që e gërryente përbrenda me këto fjalë apokaliptike: “Të rrosh a të mos rrosh? Kjo është çështja”. Në kohët moderne, ata që e studiojnë sot veprën e madhe të dramaturgut anglez do t’i përgjigjeshin me të njëjtën monedhë: “Të kesh a mos të kesh një diplomë? Ky është halli”. Kushedi sa herë e keni dëgjuar këtë dilemë të studentëve shqiptarë, të cilët kanë lënë pas krahëve frikën e mbetjes pa një shkollë të lartë, si dhe aromën e konkurrimeve të egra në universitetet publike. Por, ky hall i dikurshëm është zëvendësuar dy-tre vitet e fundit nga një tjetër, më pak kokëçarës dhe më tepër luksoz:

Zgjedhjen njëshkolle cilësore private. Me fjalë të tjera: Të kapin fort një diplomë nga një universitet me emër në Shqipëri, e cila do t’u siguronte futjen më lehtësisht në tregun e punës. Vitet e fundit, me hapjen e një sërë universiteteve private e publike, në fushën e arsimit të lartë shqiptar konkurrenca është rritur së tepërmi, ama jo në kushte të barabarta. Nga të dhënat e marra në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës janë gjithsej 17 universitete private të licensuara, të cilat kryejnë aktivitetin e tyre kryesisht në Tiranë. Kundrejt 11 universiteteve publike që funksionojnë në të gjithë vendin. Shifra prej 5-10% e studentëve që ndjekin një shkollë të lartë private tregon se shumica dërrmuese e tyre kanë ende një

mungesë besimi te diploma që do të marrin në fund të një tre-vjeçari. Të shumta janë edhe opinionet se për arsye se studenti paguan një shumë të konsiderueshme parash për t'u shkolluar, atëherë marrja e diplomës në një universitet privat bëhet dhe më e lehtë, madje pa frekuentuar rregullisht leksionet. Provimet shihen gjithmonë si "brenda garancisë" që ka paguar familja, normalisht në gjendje të mirë ekonomike, dhe gjithkush e ka shumë herë më të thjeshtë ta marrë diplomën duke paguar 3, 4 apo 5 mijë euro në vit sesa të ndjekë çdo ditë leksionet në një universitet publik. Duke e dikur këtë handicap të opinionit shqiptar, por edhe sepse hyrja e tyre në tregun e arsimit të lartë shqiptar ishte një risi e panjohur më parë, drejtuesit e universiteteve private kanë punuar shumë për të ulur këtë dozë të theksuar mosbesimi. Gjatë viteve të fundit kanë investuar shumë në institucionet e tyre, si në ambientet e shkollës, ashtu edhe në përmirësimin e mësimdhënies, duke synuar gjithnjë standardet më të mira. Një punë e cila i ka vënë në konkurrencë me njëri-tjetrin, por dhe me universitetet publike ku ende aplikohet sistemi i shkollimit falas dhe me konkurrim.

Për të ardhur deri në fazën e akreditimit, universitetet private duhet të kalojnë edhe dy etapa të tjera, të cilat ndiqen në funksion të hapjes dhe të konsolidimit të një institucioni arsimor. Fillimisht, vjen licensimi nga Këshilli i Ministrave, në bazë të të cilit jepet leja për të hapur një institucion të arsimit të lartë. Por, në këtë pikë gjithçka mbetet në nivel deklarativ, pra se çfarë je në gjendje të bësh me themelimin e një universiteti. Në fazën e dytë, ajo çfarë të duhet është leja nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila ka për detyrë të verifikojë në terren gjithçka që është deklaruar në kërkesën për t'u licensuar. Një grup inspektorësh nga Ministria e Arsimit, i përbërë nga ekonomistë dhe inxhinierë, bën verifikimet dhe

jep vendimin për dhënien e lejes në bazë të raportit të tyre. Pjesa më e madhe e universiteteve publike i kanë kaluar këto dy faza të rëndësishme, por të pamjaftueshme për të qenë i besueshëm dhe konkurrues në treg. Çka t'i mund ta fitosh vetëm duke kaluar edhe fazën e tretë, atë të akreditimit. Kjo fazë është mjaft e rëndësishme në përcaktimin e performancës që jep një universitet dhe nuk mund të kalohet plotësisht nga të gjithë. Çdo universitet që kërkon të akreditohet pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bën një raport vetëvlerësimi me anë të studentëve dhe të stafit pedagogjik, pa përfshirë drejtuesit e shkollës, i cili më pas verifikohet nga agjencia. Kjo e fundit dërgon një grup të vetin në universitet për t'u takuar me studentët, për të kuptuar vërtet se sa janë realizuar pritshmëritë. Ky proces kryhet një herë në gjashtë vjet dhe në bazë të të dhënave të agjencisë, deri më tani janë akredituar 8 universitete private, ndërkohë që 2 të tjerë janë akredituar me kushte për degë të veçanta dhe 19 universitete janë ende të paakredituara. Por, çfarë rëndësie ka ky proces?

Marrja e akreditimit u jep besueshmërinë e munguar diplomave, përmirëson kushtet e universitetit, si dhe tregon se ku qëndrojnë defektet. Nga ana tjetër, vlen për të bindur publikun dhe tregun e punës me cilësinë e studimeve që një universitet ofron. Për të përmbushur misionin e orientimit të studentëve drejt universiteteve më të mira, si dhe për të rritur besueshmërinë të cilësia e një diplome të marrë në një shkollë private, duhet plotësuar edhe një hallkë tjetër e zinxhirit, e cila ka të bëjë me renditjen e universiteteve, çka do të jepte një panoramë të qartë për të gjithë studentët se ku ata mund të drejtohen për të shpenzuar paratë e tyre dhe të fusin në xhep një diplomë të nivelit të lartë. Është e domosdoshme që për universitetet

të kontraktojmë sa më shpejt kompanitë e ratingut (renditjes). Të klasifikohen, si privatet, ashtu edhe publiket. Ka universitete që dalin mirë, shumë mirë, shkëlqyer dhe ka të tjera që hyjnë në listën e zezë, duke u thënë qytetarëve që të qëndrojnë larg tyre. Kjo do të lehtësonte mjaft zgjedhjet e studentëve, të cilët në këtë mënyrë do të kishin një burim të besueshëm për t'iu referuar dhe të vendosnin për të ardhmen e tyre. Megjithatë nuk është se sistemi privat i shkollimit është pa defekte. Problemi i parë ka të bëjë me mungesën e një fotografie reale të tregut; pra, të dihet sa cilësi ka në treg. Ndërsa, i dyti ka të bëjë me natyrën komplementare ku gjendet sot sistemi arsimor privat, në një kohë kur duhet të kishte një natyrë konkurruese. Për shembull, ka degë të tilla si ajo e matematikës apo fizikës, të cilat janë falas në sistemin shtetëror, çka bën që këto dy degë të mos ofrohen nga universitetet private. Prandaj, po ndihet gjithnjë e më shumë nevoja për një sistem të njëjtë degësh, si në atë publik, ashtu edhe në atë privat, në mënyrë që studentët të zgjedhin. Universitetet private janë një realitet i ri në fushën e arsimit të lartë shqiptar, i cili po ecën me hapa gjigante drejt standardeve europiane. Paralelisht me to, universitetet publike kanë hyrë me kokë në debatin mbi paqartësinë e aplikimit të Kartës së Bolonjës, saqë askush nuk është më i sqaruar: As ata që e futën për t'u aplikuar në shkollat shtiptare, as vetë studentët.

Duke e pasur në mendje dhe duke ju kthyer dilemës së maturanit, mendohet se realiteti i arsimit të lartë në Shqipëri është kaotik, i mbushur me kontraste dhe reagime kontradiktore midis atyre institucioneve që realisht duhet të operojnë si hetues në arsimin tone.

KU E KONSTATOJMË KËTË REALITET KAOTIK?

Së fundmi në Shqipëri, shteti po aplikon disa praktika mbështetëse për liberalizimin dhe privatizimin e një pjese të sektorit të arsimit. Ndërkohë ajo që të bie në sy është se shumicën e opinionit të pergjithshëm të shoqërisë sonë e dominon një skepticizem mbi këto hov te sektorit privat mbi arsimin dhe nuk përbën çudi që këta të fundit e krahasojnë sektorin privat të arsimit si një "ndërmarrje ku fabrikohen diploma". Por krahas dëshirës së shtetit për t'i bërë një krahmarje arsimit dhe edukimit privat, çuditërisht në Shqipëri ende nuk ka disa standarte bazë, norma dhe kritere rregulluese që të shërbejnë si "aparate" matëse të cilësisë së arsimit të lartë. Gjithashtu ne nuk kemi as edhe një renditje të universiteteve më cilësore nga shteti shqiptar, gjë që na bën të mendojmë dhe kuptojmë deri diku dhe apriori që ky realitet kaotik tanimë na shfaqet në sfond si pasojë e një konkurrence në fushën e arsimit të pakontrolluar nga shteti. Atëherë çfarë është e gjithë kjo fushatë publicitare midis universiteteve private? Mjafton të shikosh televizionet tona, të shikosh se si janë mbushur me spote publicitare mbi këto universitete. Vallë çfarë është e gjithë kjo që po i harliset para syve të riut shqiptar? Nje përpjekje rekrutimi të studentëve me anë të njohjes mediatike dhe realiteteve vetëvlerësuese që ato predikojnë, apo është një konkurrence akoma e pa kontrolluar seriozisht nga shteti? Ne duhet të anashkalojmë këtë fakt për të theksuar se keto universitete bashkë-ekzistojnë brenda një tregu pa rregulla. Në fund të gjithë kësaj dhe duke qëndruar brenda këtij lloj realiteti, i duhet lënë në dorë maturanit të zgjedhë midis publikut dhe privatit. Reagimi dhe shqetësimi vjen jo vetem nga ky realitet, por sepse përtej kesaj fushate publicitare, përtej shqetësimit të maturanit dhe studentit, përtej çeshtjes se akreditimit dhe njohjes së diplomave, kemi të bëjmë me një çeshtje edukimi kombëtar.

KUR'ANI

& BESIM

ENCIKLOPEDI në duart tona

PARA ÇDO
DITURIE

“Kur flasim për dituri dhe shkencëtarët na duken të mëdhenj. Medito për Zotin e shkencëtarëve sa i Madhëueshëm është Ai!”

KRIJIMI I NJERIUT

Në shumë ajete, njerëzve u bëhet thirrje që të përqendrojnë vëmendjen në krijimin e tyre. Shumë shpesh atyre u kujtohet ardhja në jetë e njeriut, fazat në të cilat ka kaluar krijimi i tij dhe se çfarë është ai në thelb: *“Ne ju kemi krijuar juve; përse pra nuk e pranoni të vërtetën?! A keni menduar ndonjëherë për farën (spermen) që nxirni? Mos vallë ju e krijoni atë, apo jemi Ne krijuesit e saj?”* (El Uakia 57-59) Krijimi i njeriut, bashkë me mrekullitë e shumta që përmban, është theksuar në mjaft ajete të tjera. Disa pjesë të informacionit të përmendur në disa ajete kuranore janë kaq të hollësishme sa që është e pamundur që një njeri, i cili ka jetuar në shekullin VII të kishte njohuri për to. Disa prej këtyre pikave janë si më poshtë:

- 1-Njeriu nuk është krijuar nga etërë fara,

por nga një pjesë mjaft e vogël e saj.

- 2- është mashkulli ai që luan rol në përcaktimin e gjinisë së fëmijës dhe jo femra.
- 3- Embrioni njerëzor ngjitet në mitrën e nënës si një shushunjë.

- 4- Embrioni zhvillohet brenda tre errësirave (shtresave) në mitër. Në kohën e shpalljes së Kur'anit, njerëzit e dinin me siguri që faktori bazë në lindjen e njeriut ishte fara (sperma) e mashkullit. Po ashtu, fakti që foshnja lind mbas një periudhe prej nëntë muajsh kuptohej nga të gjithë dhe s'kishte nevojë për vëzhgime të mëtejshme. Ndërsa informacioni i përmendur në pikat që cituam më lart ishte i paarritshëm dhe i konceptueshëm nga niveli i njohurive që zotëronin njerëzit e asaj kohe. Këto të dhëna u vërtetuan në mënyrë shkencore vetëm në shekullin XX.



Tani le t'i studiojmë këto pika:

Një pikë e farës

Gjatë marrëdhënieve seksuale, nga organi seksual i mashkullit dalin njëherësh rreth 250 milionë spermatozoide, të cilët nisin një udhëtim të mundimshëm në trupin e femrës, derisa arrijnë te veza. Nga 250 milionë spermatozoide vetëm një mijë prej tyre ia dalin të arrijnë në destinacionin e duhur. Në fund të kësaj "gare", veza lejon vetëm një qelizë spermatozoide që të depërtojë brenda saj. Ky është thelbi i njeriut, i cili nuk është krijuar nga e tërë sperma, por nga një pjesë shumë e vogël e saj. Në Kuran thuhet: "A mos mendon njeriu se do të lihet pa u ngarkuar me përgjegjësi. A nuk ka qenë ai dikur një pikë e farës që derdhet?" (El Kijame 36-37) Siç shihet, Kur'ani na informon se njeriu nuk është krijuar nga e gjithë sperma, por nga një pjesë shumë e vogël e saj. Ky fakt që theksohet në këtë shpallje është zbuluar prej shkencës bashkëkohore dhe është një dëshmi e qartë e origjinës hyjnore të saj.

Përzierja në farë (spermë)


Fara nuk përmban vetëm spermatozoide, por edhe një përzierje lëngjesh të ndryshme. Këto lëngje kanë funksione të ndryshme, siç është mbajtja e sheqerit, i cili është i nevojshëm për t'u dhënë energji spermatozoideve, neutralizimi i acideve gjatë hyrjes në mitër dhe krijimi i një ambjenti rrëshqitës në mënyrë që t'u lejojë lëvizje të lirë spermatozoideve. Kur përmendet fara në Kur'an, ajo përshkruhet si një lëng i përzier: "Ne e krijuam njeriun prej një pike uji të përzier me qëllim që ta sprovojmë atë" (El Insan 2) Në të theksohet se njeriu është krijuar nga "esenca" e kësaj përzierje:

"Ai e përsosi krijimin e çdo gjëje dhe filloi krijimin e njeriut nga balta. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të shtohen prej esencës së një lëngu të dobët." (Es-Sexhde 7-8). Fjala arabe "sulale" e përkthyer si "esencë", nënkupton diçka esenciale ose pjesën më të mirë të dickaje. Në raste të tjera ajo nënkupton "një pjesë të një tërësie". Kjo tregon që Kur'ani është fjala e Atij që e nje krijimin e njeriut në detajet më të hollësishme. Ai është Zoti, Krijuesi i njeriut.

VAJZË APO DJALË?

Si përcaktohet gjinia e foshnjës

Jo shumë kohë më parë mendohej se gjinia e foshnjës përcaktohej prej qelizave të nënës. Ose me saktë, besohej se gjinia ishte e përcaktuar nga qelizat e mashkullit dhe të femrës së bashku. Por në Kur'an na është dhënë një informacion i ndryshëm, sipas të cilit të dy gjinitë janë krijuar nga "pika e farës që hidhet". "Ai i krijoi të dy gjinitë, mashkullin dhe femrën, prej pikës së farës që hidhet." (En-Nexhm 46-47) Përmendja e dy gjinive nuk është e rastësishme. Nëse Zoti do të kishte




për qëllim thjesht krijimin e njeriut, atëherë në ajet do të thuhej "Ai e krijoi njeriun? prej pikës së farës." Mirëpo ajeti na informon se Zoti i krijoi të dy gjinitë prej pikës së farës? Zhvillimi i gjenetikës dhe biologjisë molekulare ka vërtetuar shkencërisht saktësinë e këtij informacioni të dhënë në Kuran. Tani është e qartë se gjinia përcaktohet nga qelizat spermatozoide të mashkullit, ndërsa femra nuk luan asnjë rol në këtë proces. Kromozomet janë elementet bazë në përcaktimin e gjinisë. Dy nga 46 kromozomet, të cilat përcaktojnë strukturën e njeriut, janë të njohura si kromozomet seksuale. Këto dy kromozomet të mashkullit janë emërtuar "XY", ndërsa te femra "XX", sepse forma e këtyre kromozomeve ngjason me shkronjat përkatëse. Kromozomi Y mban kodin gjenetik të mashkullit, kurse kromozomi X atë të femrës. Formimi i një qenieje njerëzore fillon me ndërthurjen e një prej këtyre kromozomeve, i cili gjendet si te çiftet e mashkullit, ashtu edhe te ato të femrës. Te femra, komponentet e qelizës seksuale, të cilat ndahen në dy pjesë gjatë ovulacionit, mbajnë kromozomet X. Qeliza seksuale e mashkullit, nga ana tjetër, prodhon dy lloje të ndryshme qelizash spermatozoide, njëra prej të cilave përmban kromozomet X, ndërsa tjetra Y. Nëse një kromozom X i femrës bashkohet me një qelizë spermatozoide, e cila përmban një kromozom X, atëherë fëmija do të jetë femër. Nëse ai bashkohet me një qelizë spermatozoide që përmban kromozomin Y, fëmija do të jetë mashkull.

Me fjalë të tjera, gjinia e foshnjës përcaktohet nga ai kromozom i

mashkullit që bashkohet me vezën e femrës. Asgjë prej këtij informacioni nuk dihej para shekullit XX, gjatë të cilit u zbuluan gjenet. Në të vërtetë, më parë besohej se gjinia e foshnjës përcaktohej nga trupi i femrës. Kjo është edhe arsyeja pse gratë fajësoheshin kur lindnin vajza. Trembëdhjetë shekuj para zbulimit të gjeneve, në Kur'an shpallet lajmi i cili hodhi poshtë këtë besim të kotë, duke bërë të qartë se gjinia e njeriut nuk e ka pikënisjen nga femra, por te sperma e mashkullit. Shkenca arriti ta zbulojë faktin e përmendur në Kur'an vetëm në shekullin XX.

Ngjitja e lëngut të mpiksuar në mitër

Nëse do të vazhdonim t'i studionim më tej argumentet e shpallura në Kur'an rreth formimit të embrionit të njeriut, do të hasnim në disa mrekulli shkencore të tjera shumë të rëndësishme. Kur qeliza spermatozoide bashkohet me vezën e femrës, fillon të formohet qeliza bazë e embrionit. Qeliza e vetme, e cila njihet në biologji me emrin "zigotë", fillon menjëherë të riprodhohet nëpërmjet ndarjes dhe më pas shndërrohet në një "copë mishi" të quajtur embrion. Sigurisht që kjo mund të shihet nga njerëzit vetëm me ndihmën e mikroskopit. Sidoqoftë, gjatë periudhës së zhvillimit, embrioni nuk qëndron në zbrazëtirë. Ai ngjitet në mitër siç ngjiten rrënjët e një bimë, të cilat fiksohen fort në tokë nëpërmjet lozeve të tyre. Nëpërmjet kësaj lidhjeje, embrioni arrin të marrë prej trupit të nënës substancat e nevojshme të jetës. Në këtë pikë, një mrekulli mjaft domethënëse është shpallur në Kur'an. Duke iu referuar zhvillimit të embrionit në barkun e nënës, Zoti përdor në Kur'an fjalën "alek", e cila është dhe faza e parë e përshkrimit të zhvillimit të tij. "Lexo me emrin e Zotit tend, i cili krijoi çdo gjë. Krijoi njeriun prej alekut (në mitrën e nënës). Lexo, se Zoti yt është më bujaril!" (El-Alek 1-3) Nga ana gjuhësore, fjala "alek ka kuptimin e "dickaje të varur apo të ngjitur në diçka tjetër". E njëjta fjalë përdoret për të përshkruar shushunjat që ngjiten në trup për të thithur gjakun.



Sigurisht, përdorimi i kësaj fjale për të përshkruar në mënyrë mjaft të përshtatshme zhvillimin e embrionit në barkun e nënës, vërteton edhe një herë se Kur'ani është shpallje nga Zoti, Zoti i gjithçkaje. Në fazën e parë të zhvillimit, foshnja në barkun e nënës është në formën e zigotes, e cila ngjitet në mitër me qëllim që të ushqehet prej gjakut të nënës. Ky fakt, i cili u zbulua nga embriologjia bashkëkohore, është një mrekulli e shpallur në Kuran 14 shekuj më parë me anë të fjalës "alek".

Mbështjellja e muskujve rreth kockave.

Një nga ajetet që përshkruan fazat e zhvillimit të embrionit të njeriut pohon faktin se në barkun e nënës në fillim zhvillohen kockat dhe me pas muskujt: "Pastaj e shndërruam pikën në "alek", pastaj "alekun" e shndërruam në copë mishi, pastaj këtë copë mishi e shndërruam në eshtra, pastaj eshtrave u veshëm mishin, pastaj e bëmë njeriun krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është Zoti, Krijuesi më i mirë." (El-mu'minun 12-14)

Deri pak kohë më parë, embriologët ishin të mendimit se kockat dhe muskujt në embrion zhvillohen në të njëjtën kohë. Për këtë arsye, për një kohë të gjatë, disa njerëz pretendonin se këto ajete ishin në kundërshtim me shkencën. Por kërkimet e fundit mikroskopike, të ndihmuara nga avantazh i i teknologjisë moderne,

zbuluan se shpallja në Kuran është e saktë.

Vëzhgimet në nivele mikroskopike treguan se zhvillimi i embrionit në barkun e nënës ndodh në përputhje të plotë me përshkrimin në Kuran. Së pari, indet kërcore të embrionit kthehen në kocka. Me pas, qelizat muskulore, të cilat formohen prej indeve përreth kockave bashkohen dhe mbështjellin kockat. Ky proces është shpjeguar si më poshtë në librin e mirënjohur, Zhvillimi i njeriut, i cili është shkruar nga një prej shkencëtareve më të spikatur në fushën e anatomisë dhe embriologjisë.

Kockat e foshnjës mbasi zhvillohen krejtësisht në barkun e nënës, vishen me mish gjatë një faze të veçantë. Shumë prej fazave të zhvillimit të fëmijës në barkun e nënës janë shpallur në Kur'an. Siç thuhet edhe në ajetin e katërbëdhjetë të sures El Mu'minun, indet kërcore të embrionit, në fillim, shndërrohen në kocka. Pastaj kockat vishen me qeliza muskulore. Zoti e përshkruan këtë zhvillim në ajetin: "Pastaj mudgan e shndërruam në eshtra, pastaj eshtrave u veshëm mishin." Gjatë javës së shtatë, skeleti fillon të shpërndahet nëpër tërë embrionin dhe kockat marrin formën e tyre natyrale. Në fund të javës së shtatë dhe gjatë javës së tetë, muskujt zënë vendin e tyre rreth formave të kockës. Pra, fazat e zhvillimit të njeriut të përshkruara në Kuran janë në harmoni të plotë me zbulimet e embriologjisë bashkëkohore.





Luanët ishin absolutisht më të shumtë se lepujt në një “shoqëri” shtazësh. Sigurisht që ishin më të fortë, më guximtarë. Një ditë, kur lepujt kërkuan të drejta të barabarta për të gjithë dhe barazi në fushën e lirive “shtazore”, luanët u përgjigjën: “Ju doni të jeni të barabartë me ne? Po ku i keni kthetrat dhe dhëmbët?”

(Nga një Fabul e Ezopit)

Nocioni i barazisë shtrihet në shekuj, vërtitet përgjatë luftërave të “ftohta” ku mbizotëron vlera, dija, virtyti dhe besimi e nga ana tjetër forca, pushteti dhe pasuria, e ajo që është më e rëndësishmja përpëlitet të ashtuquajturve “qenie”. Historikisht janë ndeshur e përplasur alternativat e mundshme të definicionit të barazisë që qëndrojnë në dy boshte. Boshti i parë konstaton në të parit e barazisë si një hapësirë ku të gjithë individët duhet të kenë mundësi të barabarta në përfitimin e kësaj barazie dhe boshti tjetër konstaton në domosdoshmërinë e të qenit të barabartë. Duhet të dimë se barazia prek të gjitha fushat e jetës, të tilla si: ato ekonomike, politike, shoqërore, etj. Ajo që e dallon një qenie njerëzore nga kafshët është pikërisht intelekti, aftësia për të menduar dhe logjikuar, meqë diversiteti është i pashmangshëm, dhe

kjo ka baza natyrore, një individ nga një tjetër e dallon sasia dhe cilësia e inteligjencës të fituar nga edukimi dhe pastaj ushqyerja e këtij edukimi nëpërmjet përvojës. Në kontekstin e barazisë kjo çështje qëndron në dhënien e të gjitha shanseve dhe mundësive të barabarta për fitimin dhe ushqyerjen e edukimit. Meqë rruga drejt këtyre përvetësimeve nuk është e lehtë, përkundrazi do një stërmundim dhe lodhje të madhe është në të drejtën e tyre shpërblimi në bazë të meritave e aftësive. Ky përbën nocionin e “Drejtësisë” barazia dhe drejtësia janë shumë afër njëra-tjetrës por mjafton një keqkuptim i vogël që të arrijnë të marrin rolin e dy poleve të kundërta. Drejtësia konstaton në hetimin dhe interpretimin e barazisë. Shoqëria sa vjen dhe është në zhvillim dhe janë të nevojshme personat e duhur për të qenë bashkëudhëtar të këtij zhvillimi. Por të kthehemi më në bazë të temës sonë, me

Lindim të barabartë... marrim rrugëtime të ndryshme

nga: Izmina Zejnuni, Shkodër



qëllimin që të jemi të mirinformuar për shkaqet që të çojnë në një mosbarazim. Kemi të bëjmë me shkaqe të lindura që shkaktajnë pabarazi të tilla si: jo të aftë fizikisht apo mendërisht, këto shkaqe janë quajtur shkaqe natyrore. Gjithashtu për një nga shkaqet e tjera flitet pikërisht në pjesën e parë të shkëmbimit, konkretisht për mundësitë që i jepet çdonjërit nga ne për të qenë të barabartë. Dhe shkaku tjetër ka të bëjë me përvetësimin e disa aftësive që bëjnë diferencën dhe janë vatër pabarazie.

Shkaku i parë është një fatkeqësi që nuk është zgjedhja jote dhe mundësitë për të fituar përsëri statusin i barabartë janë të vogla për të mos thënë të pamundura. Shkaqet e tjera janë përgjegjësi e drejtpërdrejt e individit, si fillim e pastaj e të gjithë shoqërisë. Por për t'i shpjeguar më mirë dhe më saktë të sipërpërmendurat, le të japim një shembull jetik që besoj se na ka ndodhur të gjithëve. Kur dy pjesëtarë të një grupi punojnë për të njëjtën qëllim dhe kanë përgjegjësi të barabara për mbarëvajtjen e punës, njëri nga ato punon dhe shërben deri në detaj duke i plotësuar të gjitha detyrimet e tij, ndërsa pjesëtari tjetër i grupit nuk është i përkushtuar aspak, për të tilla arsye si: papërgjegjshmëria dhe paafërsia e tij për atë lloj pune. Mbarëvajtja e punës do të vlerësohet në nivel grupi dhe jo në nivel individual dhe ajo për të cilën kontribuon vetëm njëri nga pjesëtarët e grupit shpërblehet njëlloj për të dy pjesëtarët. Këtu shtrohet pyetja: Sa është e drejtë kjo? Prandaj duhet që barazia të shikohet në dhënien e shanseve dhe mundësive të barabarta për të gjithë, por në garantimin e punës në bazë të virtetit që përkufizohet: bëj atë që di të bësh më mirë. Po të hedhim një vështrim në periudhat e kaluara, sidomos në periudhën e ushtrimit të skllavërisë do të vihet re një pabarazi e skajshme ose më saktë një personalizim i barazisë nga ai që ka në dorë pushtetin. Sistemi i kastave bazohet në një barazi të thellë, ku nëse një individ lind nga një familje e varfër ashtu do të vdesë dhe e kundërta. Në këtë sistem nuk i jepej asnjë mundësi një individit pjesëtar i kastës së ulët të ngjisë shkallët e hierarkisë, përveç femrave të bukura ku fati mund t'i çonte edhe në kastën më të lartë nëpërmjet martesave. Ky lloj sistemi është një shembull tipik i mosdhënies së mundësive të barabarta për të gjithë dhe prandaj në ato kohë barazisë i vishej një tjetër kuptim. Megjithatë në kohën ku ne jetojmë është tjetërsuar sepse një individ mund të ngjisë shkallët e hierarkisë në bazë të meritave apo aftësive. Sot njeriu është i lirë plotësisht dhe e menaxhon këtë liri në mënyrë

individuale, asnjë individ tjetër nuk ka të drejtën të ndërhyjë në vendimmarrjen e këtij personi deri në pikën ku nuk çenohet hapësira e tij e lirisë. Më kujton kjo shprehjen "Liria jote mbaron aty ku fillon liria e tjetrit". Le të shfrenojmë për një moment imagjinatën tonë dhe të mendojmë për një botë ku të gjithë janë të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe ku diversiteti nuk ekziston, të shohim pak se si dhe sa mund të funksionojë ky lloj sistemi dhe si do të ndryshonte sjellja e njerëzve në përshtatje të këtij sistemi. Duke iu referuar përvojës njerëzore, natyrës së njeriut si një qenie egoiste ky lloj sistemi do të përhapte një kaos të vërtetë. Por në kohën e sotme ngaqë ekziston diversiteti në barazi ka një emancipim dhe zhvillim të botës njerëzore, përndryshe pse do të ishte e nevojshme ekzistenca e ligjeve, normave, rregullave dhe e vetë shtetit.

Përkundrazi, meqë ekziston ky diversitet dhe kjo barazi në konceptin e dhënë më sipër janë të nevojshme të gjitha këto organe strukturore që të merren me hetimin dhe interpretimin e barazisë apo mosbarazisë. Këto shihen të nevojshme për të vendosur një bosht referimi sepse edhe kjo formë e barazisë të shpjeguar më lart dhe të praktikuar në ditët e sotme ka disavantazhet e veta dhe këto vijnë kryesisht në keqinterpretimin e kësaj forme të barazisë. Çuditërisht në skenat shoqërore shfaqen qenie të ndryshme individualiste që shkojnë tej në egoizëm duke e pranuar kurdoherë dhe e vlerësuar veten. Çdo person është vetvetja, ai s'është vetëm vetvetja, dhe në mendimet egoiste dhe mbivlerësuese të tij, ai është gjithçka. Në këtë kontekst, vërehen më pas kokëçarjet ndaj tjetrit, madje edhe në eliminimin e tjetrit. Kjo shkon më tej, kur dhe puna, që parimisht është një përpjekje për të ardhmen tonë dhe më pas të pasardhësve tanë, kthehet në diçka të kotë; njeriu mendon vetëm si të grumbullojë pasuri përmes parasë së fituar lehtë, ai nuk ka më as qejf të prodhojë por thjesht të qarkullojë paranë të fituar lehtë. Po sikur qenie të tilla të vijnë të vijnë e të shtohen gjithnjë e më shumë, si do të vendoset kjo e ashtuquajtur barazi në kontekstin e shpërndarjeve të fuqisë (duke iu referuar përkufizimeve që u parashtuan gjatë këtij shkrimi) kaq e domosdoshme për të gjithë ne? Kjo pyetje nuk ka një definim të patundur sepse çdokush e sheh barazinë dhe shpërndarjen e saj në mënyra të ndryshme por një pseudopërgjigje mund të jepet, e tillë si kjo: Barazia dhe shpërndarja e saj duhet të bazohet te vlerat, aftësitë dhe potenciali që paraqet dhe shpreh një individ e jo në bazë të interesave, pushtetit, përfitimeve vetjake sepse është pjesë e të drejtës natyrore dhënia e shpërblimit në bazë të punës, mundit dhe lodhjes.

Kur flasim për Barazi

Transmetohet se Ebi Hurejre ka thënë: Tha Profeti alejhis selam: **Çdo foshnje lind me natyrë të pastër, prindërit janë ata që e bëjnë çifut, të krishter apo zjarrputist etj**”

Hadithi i profetit ka për qëllim përbashkësinë e përkatësisë fetare ndërnjerëzore e cila në origjinen e saj [perkat.fetare], është një, e kulluar nga çdo shfaqje e ngjashme jo identike me të, është një aftësi nëse mund t'a quajmë kështu, e cila potencialisht i dhurohet natyrës humane për ta njohur botën dhe përshtatur veten asaj sipas ligjeve fetare. Themi potencialisht për shkak të devijimit të mëpasëm që përmendet në thënien e profetit, sipas të cilit potencialiteti fetar shndërrohet në një tjetër potencialitet që jo çuditërisht ka për tendencë të mohojë të parin, mohim i cili ndodh mbi bazën një intuete të asaj që jemi në realitet e të atyre që duam të bëhemi për shkak të arsyeve nga më të njohurat e më të panjohurat, të cilat mund të jenë sociale, ekonomike, gjinore, racore, por edhe psikologjike, individuale. Duke e marrë si të mirëqenë faktin që thelbin tonë e përkufizon islami, sipas ajetit kuranor: “Ai edhe më parë, e edhe ky kuran ju quajti muslimanë”. Haxh 78, pra duke pohuar dëshminë e besimit, themi që këtë besim nuk e përcaktojnë ritet aq sa e përcakton besimi i saktë në Zotin e vërtetë, e kjo për të vërtetuar koherencen e muslimaneve para dhe pas shpalljes së Kur'anit e jo për të mohuar kategorikisht ritet e islamit, ashtu siç në mënyrë të paditur ndodh me të gjithë ata që injorojnë ritet e kultet duke u mjaftuar me besimin tek Zoti.¹ Kjo është një nga mënyrat që përcaktojnë

diversitetin njerëzor, i cili në marrdhënie me ajetin kuranor: “O ju njerëz vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise në mënyrë që të njiheni ndërmjet jush” Huxhurat 13.

Por pas shumë debatesh dhe mjaft tryezash të organizuara themi sërish: A është e mundur barazia brenda kuadrit të diversitetit të çdo lloji?

- Çfarë kuptojmë me barazi e si duhet përkufizuar ajo në raport me aftësitë dhe larmitë e jetës njerëzore që nga njëra anë është individuale (që perjashton format identike) dhe nga ana tjetër sociale (që përthith format e ngjashme)
- A është i nevojshëm diversiteti dhe në ç'mënyrë bëhet ai promotorr njohës e zbërthyes i vlerave tona qoftë negative apo pozitive?

Duke e nisur me pyetjen e parë permendim ajetin kuranor: “Nuk ka dyshim se për muslimanet e muslimanet, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtare, të përvuajturit e të përvuajturat, sadakadhënësit e sadakadhëneset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumpërmëndësit e Allahut e shumpërmëndeset e Allahut, Allahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpërblim të madh.” Ahzab 35. Ky është një ajet i cili ka zbritur posaçërisht për gratë (Umu Seleme, bashkëshorte e pejgamberit kishte thënë: “O i dërguari i Zotit, unë po dëgjoj se po



përmenden burrat në Kur'an e jo edhe gratë!" Si shkak i kësaj historie është shpallur dhe ajeti në fjalë.) për t'i treguar jo vetëm atyre, por të gjithëve se në marrëdhënie me Zotin vepra e mirë shpërblehet njëlloj qoftë ky burrë apo grua, për t'i treguar atyre se përpara Tij të gjithë janë të barabartë, ndërsa në marrëdhëniet ndërnjerëzore sigurisht që burri qëndron një gradë më lart në aspektin e përgjegjshmërisë kundrejt familjes së tij.

Vërtetim barazie është pikërisht edhe thënia e para 14 shekujve e Ibn Atait: "Aisha është më e mira se të gjithë njohësit e fikut, (jurisprudencës islame) ka qenë më e ditur dhe në krahasim me ata që e kanë rrethuar, gjykimi i saj ka qenë më i miri."

Ajeti kuranor dhe thënia e Ibn Atait dëshmojnë qartë se barazia është e mundur pavarësisht dallimit të madh ndërnjerëzor, ai gjinor. Duke e marrë si pikë referimi këtë dallim, duke e konsideruar si rrethin më të madh që brendashkruan të gjithë nivelet e përshkallëzuara të të gjithë llojeve të barazive nga ai gjinor e me rradhë, pohojmë se barazia është e mundur të arrihet në çdo nivel diversiteti, mjafton të jetë qëllim në vetvete.

Për të përkufizuar barazinë sipas ajetit kuranor dhe thënies së Ibn Atait u realizua një parantezë të pyetjes se çfare kuptojmë me barazi, për të qenë sa më origjinale dhe për t'i paraprirë në fakt një thënieje laike e cila e perkufizon shumë qarte e permblodhtazi konceptin barazi sipas se ciles: "Barazi nuk do të thotë diametër i barabartë, barazi do të thotë e drejta e gjithsecilit për t'u zhvilluar sipas diametrit të tij." Prej kësaj dalim tek pjesa e tretë e pyetjes se parë

rreth formave identike dhe formave të ngjashme, pra jetës individuale dhe asaj sociale, e drejta e individit dhe përgjegjësia për të tjerët, si e drejtë që parimisht përjashton lakminë për të qenë identike me të tjerët, përveçse me veten dhe për të qenë të përgjegjshëm si të tjerët, nga ku konstatojmë se dëshira për të qenë identike me të tjerët, na detyron të mohojmë veten, si shkak nga ku nis devijimi i natyrës së pastër islame për të cilën flet pjesa e parë e hadithit që përmendëm në fillim dhe se të qenurit të përgjegjshëm për jetën në komunitet është pika e kthimit që kalon në po të njëjtat hapa nga ku kalon edhe dëshira për të qenë identike, vetëm se kahu i lëvizjes është i ndryshëm. Kjo shpjegon se në ç'mënyrë potencialiteti i permendur në fillim të esesë shndërrohet në një tjetër potencialitet që jo çuditërisht kemi thënë ka për tendencë të mohojë të parin, pikërisht për shkak të drejtimeve të ndryshme të lëvizjes së forcës humane që sado e fortë, e zgjuar dhe e lumtur të jetë, pozitivitetin e saj e përcakton drejtimi që do të marrë. Brenda këtyre kuptimeve marrin vlerë shprehje të tilla që favorizojnë varfanjakun besimtar kundrejt pasunikut kryeneç jobesimtar e të tjera të ngjashme. Duke konstatuar në këtë mënyrë që sistemi i vlerave për ligjet vetëm prej Zotit si e drejtë ekskluzive e më të Zgjuarit do përqipemi t'i përgjigjemi pyetjes se a është e mundur barazia dhe në ç'mënyrë arrihet ajo brenda kuadrantit të diversitetit gjinor, rracor, ekonomik, kulturor, social etj, për t'a zhvendosur esenë në një nivel më konkret të ligjërimit për të parë se si realisht funksionojnë në parim të gjithë gjërat e thëna më lart.

Barazia gjinore është një nga ekuilibrat më të rëndësishëm që në mënyrë të drejtpërdrejtë përcakton standartin e jetesës. Është një ekuilibër për shkak të rregullave që bart dhe manifeston, e s'ka se si të jetë ndryshe, kur aktoret që e përbëjnë janë burri dhe gruaja, pra në tërësi është njeriu. Jo pa qëllim përmendim termin njeri si emërues të përbashkët të të dy gjinive që sado larg diferencialisht të jenë, apo t'i duken njëri-tjetrit (sepse kjo diferencë dhe masa e saj varen nga fakti se sa në të vërtetë njohim rolet tona, kë marrim si pikë referimi për ta bërë këtë, dhe sa e respektojmë në këtë rrolin e tjetrit.) gjithsesi janë nga i njëjti lloj, për të cilin thotë Allahu në Kur'an: "Dhe nga faktet (e madhërisë) e Tij është që për të mirën tuaj Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën,(gratë) ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe ne mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë." Rrum 21.

Thotë Allahu në Kur'an: Ne ju krijuam ju nga një pikë uji e me pas u shtuan burra e gra shumë". Se ku ka qenë e bartur kjo pikë uji përpara se Zoti të krijonte burrin e gruan këtë e di vetëm Ai në dijen e të cilit është gjithçka. Por ne dimë qartë që pas këtij krijimi gjithësia u ndërtua pikërisht prej kësaj pike uji të cilën gratë nuk e posedojnë si diçka të veten, por që i jepet. E ndoshta nga ketu nis dhe rëndësia pak më e madhe që Zoti i ka dhënë burrave jo në marrëdhënie me Të, por me njerëzit. Këtë e dëshmojnë ajete kuranore dhe hadithe të ndryshme që bëjnë fjalë për to. Thote Allahu në Kur'an : "Burrat janë përgjegjëgjës për gratë, ngase Allahu ka graduar disa mbi disa të tjerë dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre." Nisa 34.

Këtë rëndësi, që në fakt është çështje përparësie që e vendos njërën palë, pra mashkullin në një të njëqindën e sekondës para femrës nuk është trajtuar si e tillë nga asnjëra prej palëve, ku ajo e meshkujve në kohën e para islamit maskilizmin e vet e ka kulmuar

me varrosjen e vajzave të gjalla të porsalindura në shoqërinë arabe apo dhe ne shoqëri të tjera ku ajo është trajtuar si një qenie pa domethënie në vetvete si një send që funksionon për të tjerët. Ndërsa në kohët moderne stafeta i kalon femrave ku ajo përveçse po kërkon të jetë e barabartë, po mundohet gjithashtu të kthejë sistemin e hershëm matriarkal të jetës primitive ku ligjin e bënte gruaja (mama) duke mos e marrë në konsideratë faktin se sa më e emancipuar është bërë aq më shumë është rritur kurba e ndjeshmërisë së saj si shkak i kapërcimeve anormale që ka bërë ajo tek vetja dhe që po vetë i vuan në kurrizin e saj. Me kapërcime anormale do të kuptojmë çdo përpjekje që del jashtë kapacitetit të saj fizik, psikologjik, hormonal, kapacitet i cili funksionalisht dhe potencialisht është me pak dinamik se ai i burrave por jo në aspektin e të kuptuarit të gjerave se sa në aspektet vendim-marrëse. Kështu natyrshëm pa asnjë subjektivizëm apo feminizëm të qëllimtë pohojmë që jeta çdo ditë dëshmon se ka gra inteligjente e burra të zakonshëm, gra të devotshme e burra neglizhente, gra punëtore e burra dembele dhe anasjelltas, sigurisht. Në këtë aspekt i rikthehemi dhe një herë asaj që thamë pak më lart mbi përqindjen e përparësisë së mashkullit themi që kjo përqindje është shumë e rëndësishme deri në momentin kur bëhet më e rëndësishme se sa duhet. Kjo ndodh atëherë kur ajo përdoret si instrument, kur keqpërdoret dhe kur kthehet qëllim në vetvete. Këto forma e zbehin figurën e mashkullit i cili vepron kështu sa herë që kërkon të fshehë dobësitë e veta duke harruar që përpara se të jetë mashkull është njeri dhe si të tillë në kemi pikat tona ku takohemi e ndahemi sigurisht. Në sajë të dualitetit gjinor, por jo vetëm, formohet larmia dhe ndryshueshmëria që përben dualitetin si kusht i domosdoshëm pa të cilin ai nuk do të ekzistonte. Në këtë këndvështrim është e çuditshme



të flitet për barazi gjinore në aspektin e atyre cilësive të cilat në fakt duhet të na dallojnë e jo të na identifikojnë me njëri -tjetrin, sepse përndryshe ç'kuptim dhe ndryshim do të kishte mes të qenurit burrë e grua. Barazia në fe legjitimohet vetëm brenda kushtit ku secila prej palëve të lëvizë brenda natyrës së vet dhe jo duke këmbyer rolet dhe funksionet. Të jesh grua e të funksionosh si burrë dhe anasjelltas është një fenomen i përhapur që po e dëmton rëndë shoqërinë sot.

Tani i kthehemi pyetjes së tretë se a është i nevojshëm diversiteti dhe në ç'mënyrë bëhet ai promotor njohës e zbërthyes i vlerave tona qofshin ato negative apo pozitive për t'a lidhur me idenë kryesore të esesë: lindim të barabartë por marrim rrugëtime të ndryshme. Në fakt ardhja në jetë është një proces që përgjithësisht i ndodh të gjithëve thuajse njëloj që do të thotë se mundësia për të qenë të ndryshëm mund të na dallojë qysh atëherë. Fjala është për të gjitha mungesat fizike apo mendore që ndajnë fëmijët e shëndetshëm nga fëmijët me probleme. Megjithatë ne do të përqendrohemi tek sensi i përgjithshëm i këtij procesi nga ku nis maratona e jetës së çdo njeriu. Në perceptimin tonë si besimtarë jeta është një maratonë finishin e së cilës të suksesshëm ose jo e përcaktojnë forcat individuale dukja e të cilave përcaktohet nga vendi që zë në shoqëri në raport me të tjerët. Në këtë kuptim të tjerët janë shumë të rëndësishëm në fakt jo vetëm për të na treguar por dhe për të na provuar se sa vlejme. Ky është një vizion që jo detyrimisht vlen për të gjithë ata që s'e mendojnë kështu. Ka individe që suksesin e finishit të tyre e lidhin me arritjet ekonomike, të tjerë me arritjet në fushat e shkencës, të artit etj. Pra vizionin për jetën e përcaktojnë dëshirat tona, aftësitë tona, zemra jonë, familja, shoqëria, vendi ku jetojmë, arsimimi, kultura, pra të gjitha

këto shërbejnë si shkak për të marrë një qëndrim të caktuar ndaj botës që na rrethon. Në fakt janë instiktet dhe mënyra se si orientohen ato nga të gjitha shkaqet e përmendura më lart që në të vërtetë përcaktojnë vizionin, pasi qëllimi i ekzistencës së njeriut ka të bëjë me përjetimin e kënaqësisë dhe gjetjen e lumturisë në dallim pra nga vizioni që feja ofron për njerëzit që është pikërisht gjetja e qetësisë shpirtërore duke mos e ngatërruar me atë të lumturisë që si gjendje provokon ndjenjën e ekzaltimit të palakmuar nga feja, për shkak të funksionit çorientues të saj mbi të menduarit. Përjetimi i kënaqësisë dhe gjetja e paqes shpirtërore është ndarja thelbësore që përcakton orientimet tona, pasi normalisht ekzistojnë ndarje pafund brenda tyre që lidhen me menyrën e trajtimit të fesë dhe laicizmit.

Rrugëtimet e ndryshme brenda vizionit fetar

Qëndrimi i fesë ndaj jetës absolutisht nuk është një qëndrim komunist sipas të cilit ideologjia dhe prona janë pjesë e imponuar e përbashkët e komunitetit e as qëndrim modern sipas të cilit komunitetin e përbëjnë individë të shkëputur nga njëri-tjetri marrëdhënia e të cilëve bazohet mbi interesat e përbashkëta që do të thotë se njohja me tjetrin nënkupton përmbushje interesash, pragu i të cilave përjashton marrëdhëniet afektive. Në islam bashkohen hapësira dhe mundësia për të vepruar dhe menduar ndryshe duke respektuar e njohur të drejtat e rregullat në komunitet, që do të thotë se feja është një dimension mjaft i gjerë ku gjithsecili gjen pasqyrën e tij autentike për të parë veten. Për të qenë i suksesshëm në fe nuk ka rendësi profesioni, arsimimi, kultura, mosha, kohëzgjatja e jetës, numri i fëmijëve, gjinia, raca, vendi ku jeton etj, por rëndësi i kushtohet marrëdhënies me Zotin, dashurisë ndaj

Tij, besnikërisë, njohjes së Tij, dhe ç'është më e rëndësishmja të qënurit (i dashuri) i Tij. Lind pyetja a ekziston një probabilitet i shpërndarë kudo njëlloj tek të gjithë llojet e njerëzve për të qenë i dashuri i Zotit apo ekziston një i tillë që favorizon grupe të caktuara njerëzish. Potencialisht të gjithë mund të jenë të dashurit e Zotit, por realisht ka të tillë që janë të zgjedhur, sepse përndryshe nuk do të ekzistonte termi "eulija". Por me plot gojë mund të themi se për të qenë të tillë nuk është e nevojshme për të qenë patjetër dijetarë apo të pasur, sepse verdiktin e jep sinqeriteti, nijeti i pastër. Që do të thotë se probabiliteti është i shpërndarë tek dija dhe nijeti i pastër, që vë në të njëjtin nivel dijetarin me zdruckthëtarin para Zotit. E parë në këtë sens asnjë prind të mos shqetësohet që patjetër fëmija i tyre "të bëhet dikushi në jetë", por të shqetësohet që të mos i ofrojë modele jete të cilat kaprëcejnë mundësitë e tij, që nuk e lejojnë të njohë veten e për pasojë të mos dijë të kuptojë dallimin mes të vlefshmes e të pavlefshmes e në këtë mënyrë të jetë: po ta përblehim me një fjalë: "i tjetërsuar". Pra edhe në fëmijë ekziston një hierarki rëndësish që varen nga trajtimi i vlerave të përbashkëta. Është interesant dhe lehtësues fakti që islami ul në të njëjtën sofër të riun me të moshuarin, të varfrëin me të pasurin, të bukurin me më pak të bukurin secili me eksperiencat e veta për të dëshmuar plotësinë e fesë, për t'i shkrirë rrugëtimet në një të përbashkët në rrugëtimin drejt Zotit të botëve që na bëri njerëz të thjeshtë jo sepse jemi më pak të rëndësishëm se të tjerët, por sepse të kënaqurit me caktimin e Tij është më e rëndësishme se rëndësia që të jep pozita: që na bëri të ditur jo për të treguar se jemi më të zgjuarit, por për të na treguar se dituria vlen për të kuptuar se sa të përulur jemi para Tij, që na bëri të varfër jo për të na munduar por për të na mësuar me durimin, që na bëri të pasur jo për të

qënë në "Zoti i të tjerëve, por për të dëshmuar se vetëm Ai është i Pasuri i të pasurve, që na bëri të bardhë jo për t'u krenuar me shkëlqimin tonë, por për të na treguar se dhe nata me yje shkëlqen njëlloj, që na bëri të bukur jo për t'u dalluar nga të tjerët, por për të dëshmuar mjeshtërinë e krijimit të Tij, që na bëri burra e gra jo për të zhvlerësuar rëndësinë e tjetrit por për të na treguar se ne pa njëri-tjetrin jemi pa status dhe për të na treguar me këtë se Ai nuk ka nevojë për askënd për të dëshmuar mbi Vetën e Tij.

Rrugëtimet e ndryshme brenda vizionit laik

Vizioni laik për jetën e mbështet sensin e tij tek rregullat që njeriu i ka shpikur vetë për të rregulluar marrëdhëniet mes tyre duke lënë jashtë në këtë mënyrë si të dorës së dytë marrëdhënien e tij me Zotin. Me të njëjten lehtësi që njerëzimi ka shpikur rregullat në po të njëjtën masë edhe i ka shkelur ato, për faktin e thjeshtë sepse njerëzimi s'mund t'a njohëveten nëpërmjet vetes, por vetëm nëpërmjet Zotit Krijuesit të tij, i Cili për njerëzimin ka caktuar ligje të qëndrueshme për të rregulluar jo vetëm marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin, por edhe me veten e ç'është më e rëndësishmja me Zotin. Mund të imagjinohen rrugëtimet kaotike që ndërmerren njeriu modern. Ato janë pa drejtim, të lëna në gjysëm, dhe të pakuptimta sa kohë që njeriu nuk vendos t'i përgjigjet pyetjeve me elementare që kanë të bëjnë me qënien e tij: kush më krijoi mua? nga erdha, dhe ku do të shkoj?



SHOQËRIMI

Dëshirë apo Detyrim

Fjalën shoqëri dhe derivatet e saj i gjejmë të shkruara në pafundësi në letërsi, gazetari, lajme, ese, biseda e gjithkund. Dhe kjo për vetë faktin se fillimi dhe fundi i këtij derivati të bukur është shoqëria njerëzore. Faktori kyç i saj është qenia njeri, e cila që në momentin e parë që që shfaq ekzistencën në këtë botë ndjen nevojë të pashmangshme për shoqërinë e ngushtë të nënës së tij. Në mënyrë që të mund të marrë energji fizike, psikologjike dhe shumë dashuri mbi të gjitha. Pra ky është një trinom i pandashëm i yni që në foshnjëri. Kjo bazë dhe më tej do të zhvillohet në këtë mënyrë, në të kundërt besoj se qenia njeri do të ishte një deformim njerëzor si mungesë e kësaj baze jetike që ushqen me elementë të patjetërsueshëm ekzistencën tonë. Por mos të harrojmë se që para daljes, në jetë, që në momentin e konceptimit tonë ne kapemi fort pas mureve të shtëpisë sonë të parë njerëzore uterusit, edhe pse kjo ndodh kur ne jemi totalisht pa ndërgjegje e strukturë mendore. Kordoni ynë umbilikal që do ta quanim kordoni i jetës na mban të shoqëruar fort për nëntë muaj pas nënës. E parë në këtë këndvështrim nevoja jonë për shoqërim është që në konceptimin tonë fillestar e që pasohet në stadi të mëvonshme si atashimi me nënën, kujdestaren, gjyshërit e duke vazhduar kështu përgjatë momente pozitive ose jo, trishtim, fatkeqësi, apo momente të gëzuara ku nevoja për afërsi, ngushëllim, dashuri, mbështetje e biseda është e natyrshme. Apo thjesht nevoja për t'u çliruar nga një barrë e rëndë psikologjike shpreh nevojën e patjetërsueshme që këto copëza mozaikësh që përbëjnë jetën tonë t'i ndajmë me të tjerët.

A nuk mendoni se këtu ka vend ajo

shprehja që thotë se altruisti jep, ndan me të tjerët që të ndjehet mirë vetë? Jetët tona në vetmi do të ishin si një lule e vetme në park, apo si një bizhu diamantesh në të cilin i vetmi gur i çmuar je ti dhe gurët e tjerë e kanë lënë atë të paplotësuar! Ç'do të mendonin të tjerët për të? Do të thoshin se argjendari nuk e paska përfunduar bizhunë, apo se gurët e çmuar kanë humbur. Dhe ne nuk mund të qëndrojmë dot të vetëm njëllor si guri i kësaj bizhujë. Kjo ishte përsa i përket të afërmeve dhe shoqërisë. Kurse nevoja për të patur një shoqëri intime e të përhershme që të fal dashuri dhe anasjelltas është dhe nevojë dhe dëshirë. Është plotësim, qetësi, ngrohtësi, mburojë dhe energji për tu përballur me furtunat që të presin jashtë kësaj kornize.

Por herë herë shoqërimi është dhe detyrim aspak i ushtruar në mënyrë auditive por i detyruar nga rrethanat të cilat të diktojnë të kryesh një veprim të tillë. Gjithsesi jeta në shoqëri i përmban të gjithë këto elementë. Pa të ajo do të ishte si një pjatë që i mungojnë erëzat dhe garnitura, pa të ajo do të ishte si një vajzë e bukur e pa parfumosur, apo si një lëng frutash që i mungon athtësia dhe ëmbëlsia!!!!

Shoqërimi është dëshirë mbi të gjitha, a nuk mendoni dhe ju kështu...

Lamtumirë, muaji i begatë



Sa e vështirë është për veten lamtumira e një njeriu apo diçkaje që e pëlqen dhe sa e dhimbshme është ndarja prej tij.

Një mik të cilin e kishim në të djeshmen e afërt, duke ururar njëritjetrin për ardhjen e tij, ndërsa sot i japim lamtumirën për të qëndruar larg tij për afro një vit. Sa shpejt u largua, sa e hidhur është ndarja nga ai!

Besimtarët e devotshmëm, si ata të gjeneratave të para, por edhe muslimanët e sinqertë të ditëve tona, e kishin të vështirë që t'i lënë prapa ditët e këtij muaji dhe ndienin keqardhje të thellë për t'i dhënë lamtumirën.

U largua ky mik i shtrejtë për ne, i cili do të jetë dëshmitar pro ose kundër nesh; sipas punëve që kemi kryer gjatë tij. Ky muaj ishte një fushë mejdani në të cilin garonin, konkuronin dhe nxitonin kalorësit që kërkonin xhenetin dhe mëshirën e Allahut. Disa prej tyre garuan dhe dhe arritën fitoren, ndërsa disa të tjerë as që e morën mundimin që të futeshin në garën e veprave të mira, prandaj humbën dhe pësuan disfatë.


Në lidhje me largimin e këtij muaji do të qëndronim në tre pika:

1. Nga fjalët e mençura të dijetarëve të parë është: Të mjerë janë ata njerëz të cilën nuk e njohin Zotin e tyre vetëm se gjatë muajit të Ramazanit. Zoti i të gjithë muajve është Një, dhe sa njerëz nuk e kanë gjetur rrugën për në xhami vetëm se në muajin e Ramzanti ose në fund të tij, në namazin e Bajramit. Mbarimi i namazit të bajramit është lajmërimi i fundit dhe takimi i fundit me namazin për gjatë një viti, mbarimi i Ramazanit është për

të edhe fundi i namazit të natës dhe i leximit të Kuranit. O Zot mos na bëj që të mashtrohemi me vetet tona.

Ibn Rexhebi ka thënë: Mendjelehtët e konsiderojnë Ramazanin si diçka që iu rëndon mbi supe, sepse e kanë të vështirë faljen e namazit dhe agjërimin, ku pjesa dërrmuese e tyre janë të paditur dhe nuk kryejnë namaz vetëm se gjatë Ramazanit. E kur agjërojnë nuk i lënë mënjanë gjynahet e mëdha vetëm se në këtë muaj, prandaj i duket kohë e gjatë qëndrimi larg tyre të cilat janë bërë të natyrshme për të dhe kështu





numëron netët dhe ditët me qëllim që të rikthehet përsëri tek mëkatet e mëparshme. Këta grup njerëzish janë këmbëngulës në mëkatet e tyre dhe këtë e bëjnë me vetëdije, prandaj ata janë në rrugën e gabuar. Ka prej tyre që nuk përmbahen nga gjynahet edhe gjatë këtij muaji.

Mëshira qoftë për ata njerëz që janë sigurt se qëndrimi në këtë botë nuk është i përhershëm, por e konsideruan atë një det, kurse veprat e mira i përdorën si anije për të shpëtuar, u pajisëm me to në formën më të mirë për të dalë para Zotit.

2. Muslimani i sinqertë duhet të ketë frikë nga mospranimi i punëve të mira. Allahu ka thënë:

60. dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre, (Muminun)

Pra, bëjnë vepra të mira dhe zemrat e tyre janë të frikësuar se nuk janë të pranuar tek Zoti, sepse janë të sigurt për ndodhjen e Ditët së Kiametit dhe kthimin tek Allahu.

Aishja (Zoti qoftë e kënaqur me të) ka thënë: “E pyeta Profetin (alejhi salatu ue selam) për kuptimin e këtij ajeti dhe i thashë: A janë ta që përdorin pije alkoolike dhe kryejnë vjedhje? Jo, i tha o bija e Sid-dikut, por janë ata që agjërojnë, falen dhe japin sadeka, mirëpo frikësohen nga mospranimi i tyre. Këta janë ata që nxitojnë në vepra të mira.

Abdullah Ibn Mesudi thoshte: “Cili është ai që i është pranuar puna e mirë që ta urojmë dhe cili është ai që i është kthyer mbrapsht puna e tij që ta ngushëllojmë. Urime për atë që i është pranuar puna e mirë, dhe ngushëllime për atë që nuk i është pranuar.

3. Ramazani ishte një mundësi për të ndryshuar veten. Ti njeri që kishe i vendosur për t’u penduar dhe ia dhe besën Allahut se do të ecësh edhe më tej në bindjen ndaj tij, si i thyen këto vendime menjëherë pas muajit të agjërimit?!

Aishja ka thënë se Profeti (alejhi salatu ue selam) kur e bënte një vepër, e vazhdonte atë gjatë gjithë kohës.” (Muslimi)

Puna e besimtarit nuk ndërpritet vetëm atëherë kur t’i vijë vdekja, prandaj adhuroje Allahun deri kur të vijë ajo.

Allahu pranon vetëm punët e njerëzve të devotshëm

Aliu (Zoti qoftë i kënaqur me të) ka thënë: Jepini rëndësi pranimit të punës më shumë se kryerjes së saj. A nuk e keni dëgjuar fjalën e Allahut:

Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. (Maide 27)

Ebu Darda (Zoti qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “Nëse do ta dija me siguri se Allahu më ka pranuar qoftë edhe një namaz të vetëm, kjo gjë do të ishte më e dashur për mua se pasuria e të gjithë botës, sepse Allahu ka thënë se “Ai pranon vetëm nga të devotshmit.”

Prijësi i drejtë Umer ibn Abdul Aziz shkroi një letër duke këshilluar një burrë ku ndër të tjerat i thoshte: “Të këshilloj për devotshmëri ndaj Allahut, sepse nuk pranohet asnjë punë pa të dhe nuk mëshirohet vetëm për shkak të saj, nuk shpërblehesh vetëm se për të. Ata që flasin për devotshmëri janë të shumtë, por praktikuesit e saj janë të pakët.

Dijetarët kanë thënë: Nga shenjat e pranimit të agjërimit, është vazhdimësia e punëve të mira pas mbarimit të tij.

Mos i ngjaso guas mendjelehtë që shkatërron punën e saj

Nëse vërtet ke përfituar nga Ramazani dhe ke arritur që të fitosh cilësitë e njerëzve të devotshëm, ke agjëruar siç duhet dhe je falur me përkushtim dhe sinqeritet, atëherë falendero Allahun dhe lutu që Allahu të të forcojë në ndjekjen e të vërtetës dhe punën e vazhdueshme.

Kujdes mos e prishën dhe mos e shkatërro të gjithë këtë mund dhe lodhje, pas përfundimit të muajit të begatë.

Zoti i lartësuar ka thënë:

Mos u bëni si ajo gruaja që e prish dhe e bën fije-fije atë që e ka tjerrë fort. (Nahel)

Thuhet se një grua nga Meka kishte probleme mendore. Gjatë gjithë ditës thurte rroba dhe në mbrëmje e prishte të gjithë punën dhe mundin e saj.

A dëshiron që të futesh tek grupi që i përngjasojnë kësaj gruaje me probleme mendore ?!

Ky është shembulli i atyre njerzve që menjëherë, sapo mbaron ky muaj rikthehen tek gjynahet e mëparshme. Gjendja e këtij njeriu duket sikur thotë: Shyqyr që mbaroi Ramazani dhe tani jam i lirë dhe bëj ç'dë dua, shyqyr që e hoqa qafe se mezi po prisja këto ditë që të veproj ç'të dua! Nuk ngelet tek ai asgjë nga adhurimet e muajit të begatë. Pas një periudhe të mbushur me adhurime dhe vepra të dashura tek Allahu rikthehet sërish tek zjarri i gjynaheve dhe shturjes. Kjo është shenjë e mohimit të kësaj mirësie, të mosfalenderimit të Zotit që ta mundësoi të kryesh këto punë të mira gjatë këtij muaji.

Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja

Kur flasim për vazhdimin e veprave të pëlqyera dhe punë mira pas përfundimit të mujit të Ramazanit, nuk kemi për qëllim që të agjërojmë dhe të falemi ashtu siç vepruam gjatë këtij muaji, por të mos rikthehemi sërish tek gjynahet para Ramazanit dhe ta kujtojmë atë sado pak me disa veprime që janë kryer gjatë atij muaji.

Një herë Profetit (alejhi salatu ue selam) i përmendën disa njerëz që bënë shumë adhurim dhe Ai tha: "Kjo gjë është e domosdoshme në fenë islame dhe gjithashtu vrulli i adhurimit. Çdo punë ka kulmin e vrullit të saj. Nëse pas kësaj e pakëson adhurimin, ka vepruar mirë, por nëse dobësohet duke bërë mëkate, ata janë të shkatërruarit e vërtetë." (Ahmedi dhe Taberaniu)

Nëse vërtet të vjen keq që nuk agjëron ashtu siç veproje gjatë Ramazanit,

atëherë dije se dyert e agjërimit vullnetar-nafile janë të hapura në çdo kohë. Profeti (alejhi salatu ue selam) agjëronte gjithmonë tri ditët e bardha të çdo muaji hënor, përkatësisht në datat 13, 14, 15, madje nuk i linte pa agjëruar asnjëherë edhe nëse ishte në udhëtim.

Nëse dëshira për agjërim është më e madhe se kaq, meqenëse para kemi stinën e dimrit dhe dita është mjaft e shkurtër, atëherë mund të agjërosh ditën e hënë dhe të enjte, për të cilat Profeti (alejhi saltu ue selam) ka treguar se gjatë këtyre dy ditëve dorëzohen të gjitha punët tek Allahu, prandaj dhe dëshironte të ishte agjërueshëm. Agjërimi më i mirë është agjërimi i profetit Daud (alejhi selam) një ditë agjëronte dhe një ditë jo, për atë që e gjykon se ka mundësi.

Po kështu pëlqehet agjërimi i Ditës së Arefatti dhe ditës së Ashurasë.

Nëse ndjen keqardhje që nuk e fal namazin e teravive në muajt e tjerë, dije se namazi i natës është namazi më i pëlqyer pas namazeve të detyruara gjatë gjithë muajve të vitit. Është një kohë që Allahu zbret në qiellin e dynjasë dhe pret nga ne t'i lutemi, t'i kërkojmë falje dhe t'i tregojmë hallet dhe prolemet tona dhe ai t'ju përgjigjet atyre dhe t'i pranojë duatë.

Nëse të vjen keq që nuk jep sadekanë e fitrit, gjatë muajve të tjerë, dije se Allahu ka caktuar zekatin, shtylla e dytë e islamit. Një pjesë e vogël e pasurisë që jepte nga të pasurit, tek njerëzit në nevojë. Ndërsa sadekaja vullnetare është e lejuar dhe e pëlqyer në çdo kohë dhe nga të gjithë njerëzit pavarësisht pasurisë që posedon.

A dëshiron të arrish shpërblimin e agjërimit të një viti të plotë?

Ata njerëz që kanë ambicie të mëdha dhe synime të larta për të arritur kënaqësinë nëpërmjet agjërimit kanë një mundësi të artë për të arritur shpërblimin e një viti të plotë. Profeti (alejhi salatu ue selam) ka thënë: "Kush agjëron muajin e Ramazanit dhe

e pason atë me agjërimin e 6 ditëve të maujit Sheual (muaji pasardhës i Ramazanit) konsiderohet sikur ka agjëruar të gjithë kohën.” Sa e mençur dhe e goditur është fjala e baballarëve dhe nënave tona që kanë arritur moshën e pleqërisë të cilët nuk i lënë pa agjëruar këto 6 ditë dhe shprehen duke thënë: Po përcjellim muajin

e Ramazanit. A nuk duhet që këta njerëz me këtë besim të palëkundur të ndiqen dhe të jenë shembulli më i mirë nga brezat pasardhës duke trashëguar kështu një veprim të prijësit të besimtarëve të devotshëm, Muhamedit (Paqja e Allahut qoftë mbi të).

Takimi i fundit, dialog me muajin Ramazanit

Mu drejtua i mërzhitur dhe i pikëlluar: Unë do largohem tani...

Sytë e mi filluan të nxjerrin lotët me vrull dhe zemra e lënduar ndiente dhimbjen e ndarjes.

Mos ik, i thashë sepse unë të dua ty. Sa shumë të kam pritur dhe sa mall kam ndier për ty, numëroja ditët, madje edhe çastet derisa të të takoja, orët e pritjes ishin çastet më të lumtura për mua dhe fundi i çdo dhimbjeje.

Po si do largohesh tani dhe të me lësh mua të vetëm, i çoroditur në brigjet e humbjes duke lundruar në dallgët e errëta të jetës plot sfida? A do ikësh ndërkohë që unë kisha thurur për takimin tënd shpresat dhe endërrat e mia! Të lutem mos u largo!

Ai m'u përgjigj duke më thënë: Mjaft derdhe lot, mjaft rënkove nga mallëngjimi, sepse çdo fillim ka një mbarim, patjetër që ora e ndarjes do vinte një ditë. A nuk e ke dëgjuar Xhibrilin (alejhi selam) i cili i drejtohet Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të) “O Muhamed, jeto sa të dëshirosh, por një ditë do vdesësh, duaj cilindo, por një ditë do ndahesh nga ai...”

Pra, unë do largohem, por edhe unë si ti jam i pikëlluar, madje më shumë për ata të dashur që jetova mes tyre, më nderuan dhe treguan shumë respekt ndaj meje, sa që shpresova që të qëndroj përgjithmonë me ta

Unë largohem nga disa të tjerë dhe më vjen keq për ta, më vjen të qaj dhe mërzhitem shumë për fundin e

tyre. Këta njerëz nuk më nderuan dhe as që i njohën vlerat që kam. Më lanë ashtu të poshtëruar me zemër të thyer dhe nuk gjeja vend në zemrat e tyre.

Mua nuk më prish punë pse më pritën me fytyrë të vrenjtur dhe më lanë pas dore, por u tmerrova nga ato zemra dhe ngurtësia e madhe e tyre, sa që fillova të pyes veten: A e meritojnë këta njerëz që të qaj dhe të lotoj për ta nga keqardhja? Apo ti lë ashtu pa pendim! Jam shumë i sigurt se do ta kuptojnë vlerën time atëherë kur do t'ju mungoj, do ta njohin vlerën që kam dhe do të pendohem për këtë. I kaluan orët të gjata në argëtime dhe dëfrime, në mëkate dhe gjynahe. Nuk dija se isha kaq i rëndë për ta në atë shkallë që të mjeroheshin me ardhjen time, nuk do kryenin detyrimet që kanë ndaj Allahut dhe krijesave të Tij, duke nxjerrë justifikime të paqena mbi supet e mia. Ku janë urimet dhe përshëndetjet për ardhjen time, apo ishin vetëm veprime të shtiruara dhe të pavërteta?!

Kisha dëshirë të qëndroja për ata që garuan për vepra të mira dhe jo për dëshirat e tyre pa fre, mirëpo s'kam rrugë tjetër vetëm se t'ju jap lamtumirën duke shpresuar që do t'i takoj shumë herë edhe në të ardhmen derisa t'i shikoj në xhenetet e larta.

Ndërsa për të tjerët, sa keq më vjen për ta dhe nuk kam ç'tju them gjë tjetër vetëm se të pendohen qoftë edhe pas largimit tim, sepse ndosha nuk më arrijnë dot vitin që vjen.

Njerëzit priren për të fshehtën dhe dëshira për të mësuar atë që nuk e dinë është e madhe. Studenti, posa del nga provimi, kërkon rezultatin menjëherë. Natyrshëm, çdo besimtar pas muajit Ramazan dëshiron të dijë a është në listën e të pranuarve.

Atëherë si ta di unë nëse vërtet jam i pranuar?

Përgjigja e thjeshtë dhe e lehtë do të ishte kjo:

1. Kur besimtari e gjen zemrën më afër Zotit të Lartësuar, e do Atë, ky është fryt i adhurimit dhe shenjë e pranimit.
2. Të dojë adhurimet (ibadetet) dhe ta ndiejë se dyert e adhurimeve janë hapur, kurse ato të mëkateve janë mbyllur.
3. Mos t'i lërë veprat e mira që ka bërë gjatë Ramazanit dhe gjithashtu t'i shtojë veprat e tjera që nuk i ka vepruar gjatë tij.
4. Mos t'i kthehet mëkatit prej të cilit është penduar gjatë Ramazanit.
5. Të përjetojë mirësitë.
6. Të agjërojë gjashtë ditët e Shevalit.

(AGJËRIM)

PAS NJË MUAJI PROVIM,
SA DO DOJA TË DIJA
NOTËN TIME ...!

Mesazhi në shishe





7. Të shpejtojë dhe garojë në vepra të mira.

8. Të jetë pas Ramazanit më i mirë se para tij, të ndiejë se ka një zemër të re që pulson me dashuri për Allahun, me namaz, përkujtim, falënderim.

Këto janë disa prej shenjave të pranimit tek Allahu.

Mos i prish dhe mos i humb veprat pas suksesit. Të gjitha adhurimet e bëra gjatë Ramazanit besimtari mund t'i humbasë me lehtësi nëse nuk i ruan. Sigurisht që veprat e mira duhet të ruhen. Ruajta e veprave arrihet:

Së pari: Kujdes nga tregimi dhe ekspozimi i adhurimeve

Duhet ta shohësh veten më të vogël se vëllezërit e tu dhe me më shumë mëkate e të meta se ata. Nuk është e drejtë e besimtarit të japë një gjykim mbi veprën e vet, por as të presë gjykimin e të tjerëve mbi adhurimet.

Mos të të duket vetja se ke bërë me këtë vepër diçka, por ta shohësh veprën vetëm si mirësi dhe dhuratë nga Allahu, vepër që meriton falënderim tjetër, përpjeke të vazhdueshme dhe angazhim shtesë deri në vdekje.

Së dyti: Kujdes nga vetëpëlqimi

Individi duhet të jetë i kujdesshëm nga sëmundja e mendjemadhësisë dhe e egos. Me punët e mira të realizuara nuk duhet t'i pëlqejë vetja, por të ndiejë mangësi në vetvete, duke e parë veten të rrethuar me begatitë e Allahut e jo duke parë veprën e vet.

Së treti: Kujdes nga mashtrimi

Pas kryerjes së veprës njeriu nuk duhet të mashtrohet duke menduar se është munduar dhe ka fituar.

Çdo mund dhe arritje është mirësi e Allahut, dhuratë e Tij. Çdo gjë i atribuohet Krijuesit, absolutisht asgjë njeriut.

Së katërti: Vazhdimësia e veprave të mira

Besimtari patjetër duhet të vazhdojë së vepruari. Pas Ramazanit adhurimet duhen vazhduar dhe shejtani nuk duhet lejuar që të ndikojë dhe të pengojë agjërimin, namazin dhe leximin e Kuranit.

Së pesti: Duke kërkuar ndihmën e Allahut për pengimin e preokupimeve të jetës

Me veprat e bëra që keni realizuar me ndihmën e Allahut duhet të ruheni nga mashtrimet e shejtanit. I mallkuari shton preokupime, shqetësime, ven-dos pengesa, por gjithsesi ju duhet të kërkonit ndihmën e Allahut të Lartësuar për fuqi. Nëse nuk ndodh kjo, atëherë do të shkëputeni nga punët e mira, çka do të thotë se njeriu kthehet në gjendjen e mëparshme.

Dijeni dhe mësojeni se:

- rehatia nuk arrihet me rehati;
- çështjet e larta nuk realizohen me dembeli;
- kush mbjell, korr;
- kush mundohet, gjen.

H U D I

Populli që u dënua me erërat e fuqishme
për shak të mosbesimit të tyre

**KUSH ISHIN TË VEÇANTAT E KËTIJ PROFETI,
PO TË POPULLIT TË TIJ?**

Përgatiti: Irfan Tota

Hud ibn Shalikh ibn Erfakhshed ibn Sam ibn Nuh, vinte nga fisi i Adit, disa arabë këta, që banonin në zonën e Ahkafit, e cila ndodhet në malet e Remlit në Jemen. Pjesën më të madhe të jetës e kalonin në çadra me shtylla gjigande siç i ka përmendur Allahu

6. Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad,

7. banorë të Iremit me pallate shumëshyllëshe,

8. të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?! (Fexher)

Fisi i Adit janë fisi i parë që adhuruan idhujt pas përmytjes së madhe, në kohën e Nuhut (alejhi selam), pranda për këtë qëllim, Allahu dërgoi Hudin (alejhi selam) që t'ju bënte thirrje të ktheheshin në besimin e pastër dhe rrugën e drejtë:

65. Fisit Ad101 i dërguam vëllanë e tyre - Hudin. Ai tha: "O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. A nuk po i ruheni dënimit?" (Araf)

Hudi i ftoi në njësimin e Allahut, teuhidin, dhe iu kujtoi Zotin e tyre të vërtetë, mirëpo ata e përgënjshtuan dhe e kundrështuan, e tallën dhe e përqeshën. Allahu e ka përshkruar mënyrën se si talleshin me të dhe kundërpërgjigjet Hudi (alejhi selam) ndaj tyre:

66. Paria e popullit të tij që nuk besonte, tha: "Ne shohim tek ti

mendjelehtësi dhe mendojmë se je gënjështar".67. Ai tha: "O populli im! Unë nuk jam mendjelehtë, por jam i

dërguar nga Zoti i botëve.68. Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim dhe jam këshilltar besnik.

69. A po çuditeni që këshilla e Zotit tuaj t'ju vijë nëpërmjet një njeriu prej jush, i cili ju tërheq vërejtjen? Kujtoni që Ai ju bëri zëvendës pas popullit të Nuhut dhe ju dha trup e fuqi të madhe. Kujtoni dhuntitë e Allahut, në mënyrë që të keni sukses!" (Araf)

S E R I A E P R O F E T Ë V E

Megjithatë Hudi (alejhi selam) iu kujtoi begatinë e Allahut, iu solli ndër mend dhe po Ai iu ka trashëguar Tokën pas populli të Nuhut (alejhi selam). Gjithashtu Allahu i ka bërë më të fuqishëm dhe më të fortë në trup dhe në fuqi. Të gjithë këto këshilla nuk bënë dobi, as përkujtimi i Allahut, nuk iu bëri përshtypje dhe thanë:

136. Ata thanë: “Për ne është njëlloj: na këshillove ose nuk na, këshillove ti. 137. Këto janë vetëm doket e popujve të lashtë, 138. e ne nuk do të jemi të dënuar.”

Gjithashtu i thanë:

53. Ata thanë: “O Hud! Ti nuk na ke sjellë kurrfarë prove të dukshme për fjalët e tua, ne nuk do t’i braktisim zotat tanë dhe nuk të besojmë ty!

54. Ne themi vetëm se ty të ka goditur ndonjë e keqe nga zotat tanë”. (Hud)

Pra, ata iu kundërpërgjigën profetit të tyre duke thënë se nuk ke sjellë ndonjë mrekulli apo provë që të dëshmojë se ke thënë të vërtetën. Ne nuk e lëmë, -thanë, adhurimin e këtyre idhujve vetëm për fjalët tua. Nuk u mjaftuan me kaq, por filluan ta vinin në lojë duke e konsideruar thirrjen dhe profecinë e tij, për shkak të ngacmimit dhe cytjeve të zotave të tyre ndaj tij. Në këtë kohë profeti i Zotit me qetësinë më të madhe, e cila buronte nga besimi i palëkundër tek Zoti dhe ndihma e Tij, tha:

54. Ai tha: “Unë kam dëshmitar Allahun, por dëshmoni edhe ju, se unë jam larg nga idhujt që ju i adhuroni

55. në vend të Tij. Të gjithë ju bëni komplot kundër meje dhe mos më jepni afat aspak!

56. Unë mbështetem tek Allahu, Zoti im dhe Zoti juaj. S’ka asnjë gjallesë që të mos jetë nën pushtetin e Tij. Me të vërtetë, Zoti im, është në rrugë të drejtë. (Hud)

Ky ishte një sfidim që iu bëri Hudi, sepse ai u distanca nga zotat e tyre fillimisht, pastaj i sfidoi të gjithë njëherësh duk iu kërkuar që ta dëmtonin qoftë dhe me një gjë të vetme, madje këtë sfidim e thelloi dhe e çoi më tej duke iu thënë: “Mos më jepni afat asnjë çast por bëni ç’të doni me mua, sepse unë i jam mbështetur Allahut, Zotit tim, ku udhëzimi i të gjithë njerëve është në dorën e tij.

Kur populli i Hudit i thanë atij:

70. Ata thanë: “A mos na ke ardhur që të adhurojmë vetëm Allahun e t’i lëmë zotat që kanë adhuruar prindërit tanë?! Atëherë na sill atë me të cilën na kërcënon, nëse je i sinqertë!” (Araf)

Profeti Hud (alejhi selam) iu tha:

71. Ai tha: “Tashmë, ju ka rënë dënimi dhe zemërimi i Zotit tuaj. A më kundërshtoni mua për emrat (e idhujve), të cilët ua keni vënë ju dhe prindërit tuaj e për të cilët Allahu nuk ju ka sjellë kurrfarë ditorie? Pra, pritni, se edhe unë po pres me ju!” (Araf)

Në këtë kohë zbriti dënimi i Allahut të Fuqishëm dhe ky popull shkoi në humbje. Dënim i i parë ishte ajo që është përmendur në suren Ahkaf ku Allahu thotë:

S E R I A E P R O F E T Ë V E

24. Dhe kur panë një ré që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, ata thanë: “Kjo re po sjell shiun!” “Jo!” – u përgjigj ai – “kjo është ajo që ju e keni shpejtuar: një erë që mbart një dënim të dhembshëm,

25. që, me urdhrin e Allahut, shkatërron çdo gjë.” E në mëngjes u panë vetëm shtëpitë e tyre të zbrazëta; ja, kështu e ndëshkojmë Ne popullin keqbërës.

Populli i Hudit, kur panë retë që po vinin drejt tyre, u gëzuan duke menduar se ato do të sillnin shi dhe nuk e kuptuan se ky ishte dënimi i Allahut që po afrohej. Kjo erë që mbarte me vete retë, është përmendur në Suren Haka, ku Allahu ka thënë:

6. Kurse fisi Ad u shkatërrua nga një furtunë shungulluese të rreptë,

7. të cilën Allahu ua dërgoi atyre shtatë net dhe tetë ditë pareshtur. Atëherë mund t’i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura.

8. A sheh ndonjë gjurmë të tyre?

Gjithashtu është përmendur edhe në suren Kamer:

18. Edhe fisi Ad e quajti gënjeshtar (të dërguarin Tonë), por sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia! 19. Ne u dërguam atyre në një ditë fatkeqe një erë të stuhishme

të pandërprerë, 20. e cila i nxirrte njerëzit, sikur të ishin trungje të shkulura hurmash.

Po kështu është përmendur tek surja Dharijat:

41. (Mësim ka edhe në historinë) e fisit Ad, kur i dërguam erën shkatërruese,

42. e cila, ngado që kaloi, nuk kurseu asgjë, duke i kthyer në kalbësira.

Kjo erë e fuqishme vazhdoi plot shtatë netë dhe tetë ditë. Një erë shkatërruese e cila nuk sillte asgjë të mirë, por kudo ku kalonte, e bënte hi e pluhur. Era, për shkak të vrullit të madh, e ngrinte njeriun në ajër pastaj e pëplaste me kokë në tokë e cila kthehej në një kufomë pajetë dhe pa kokë, si trungjet e palmave. Emri i kësaj ere ishte Debur.

Profeti (alejhi saltu ue salam) ka thënë: “**Më është dhënë për ndihmë era Saba dhe era Debur ka shkatërruar fisin e Adit.**” (Buhariu dhe Muslimi) Era Saba fryn nga lindja, ndërsa era Debur fryn nga perëndimi.

Allahu ka thënë:

58. Kur erdhi urdhri Ynë, me mëshirën Tonë, Ne e shpëtuam Hudin bashkë me besimtarët e tij. I shpëtuam ata nga dënimi i rëndë.

59. Ja, ky ishte fisi Ad. Ai i mohonte shenjat e Zotit të tij, nuk i dëgjonte të dërguarit e Tij dhe shkante pas urdhrin të çdo keqbërësi kokëfortë.

60. Ata i ndoqi mallkimi në këtë jetë dhe në Ditën e Kiametit. Me të vërtetë, fisi Ad e mohoi Zotin e tij. Qoftë larguar (nga mëshira e Allahut) fisi Ad, populli i Hudit!

Kështu, Allahu i shkatërron zullumqarët dhe keqbërësit, ndërsa me mëshirën e tij shpëtoi Hudin (alejhi salam) dhe besimtarët, të cilët u larguan në një vend tjetër tek i cili adhuronin Allahun të qetë.

MË DUHET
TA DI



MËNYRAT PËR

Këtu janë pesë mënyra për t'a pasur dietën tuaj nën kontroll dhe për ta përdorur ushqimin si barëra për trurin tuaj.

-1. Konsumoni sa më shumë ujë
Duke e ditur se truri juaj përmban rreth 80% ujë, hapi i parë që duhet ta bëni është që trurit tuaj ti dhuroni masën e nevojshme të ujit. Edhe dehidrimi më i vogël mund të rris stresin hormonal, të cilat me kohë e dëmtojnë trurin tuaj. Pini së paku gjashtë gota ujë në ditë. Më e mira është që lëngjet tuaj të mos përmbajnë sheqer artificial, kafeinë apo alkool. Mund të përdorni barishta, çajëra të ndryshe pa përmbajtje kafeinë dhe të bëni çaj të ftohtë pa sheqer. Çaji i gjelbër është po ashtu i mirë për funksionimin e trurit ngase përmban elementë që ndihmojnë në relaksim e trurit.

-2. Kufizoni kaloritë
Hulumtimet e fundit të bëra tek kafshët por edhe qëniet njerëzore tregojnë se dietat me ushqim jo kalorik ndihmojnë në funksionimin sa më të mirë të trurit dhe shtojnë jetëgjatësinë. Nëse hani më pak ju ndihmon të jetoni më gjatë. Mbajtja e peshës normale, zvogëlon mundësitë për infarkt, kancer dhe obezitet (mbi peshë).

-3. Peshk, vaj peshku, yndyrat e mira etj
DHA -një formë e Omega 3 e gjetur tek peshqit, përbën një pjesë të madhe të

ngjyrës së hirtë tek truri. Yndyra në trurin tuaj formon qelizat dhe luan një rol të rëndësishëm në funksionimin e këtyre qelizave. Neuronet janë po ashtu të pasura me Omega 3. DHA- ja është gjetur në sasi të mëdha edhe në retinën e syrit, pjesë e ndjeshme e syrit. Hulumtimet e bëra, në veçanti viteve të fundit, tregojnë se dietat e pasur më Omega 3 ndihmojnë që të kemi një shëndet të mirë, të jemi emocionalisht të balancuar dhe po ashtu të kemi disponim pozitiv në vitet e ardhshme, sepse DHA-ja është përbërësi kryesor i sistemit të trurit.

-4. Përdorni sa më shumë ushqim antioksidant
Një numër i studimeve kanë treguar se një dietë e përbërë nga fruta dhe perime (antioksidant) në mënyrë të dukshme zvogëlon rrezikun për zhvillimin e dëmtimeve të njohura. Këto hulumtime janë bërë për të ngritur disa teori rreth funksionimit të trurit në moshën të ndryshme. Kur një qelizë konverton oksigjenin në energji, formohen disa molekula të vogla të njohura me emrin si " rrënjë të lira". Në kohën kur këto molekula të vogla prodhohen në sasinë e duhur ndihmojnë që trupi ti lirojë toksiket (helmet) dhe kjo krijon një trup të shëndoshë. Ndërsa në





TË USHQYER

Nga Dietologe: A. Dhimo

FRURINI

kohën kur këto molekula prodhohen në formë të toksikeve ato shkatërrojnë qelizat që pastaj shkaktojnë vdekjen e qelizave dhe dëmtimin e indeve. Ky proces dihet edhe si stres oksidues. Përmët dhe perimet antioksidante janë (nga Instituti i Agrikulturës në SHBA): Boronica, Manaferra, Boronica e kuqe, Dredhëzat, Spinaqi, Mjedra, Kumbulla, Brokoli, Rrepa, Avokado, Portokalli, dhe Kivi.

-5. Proteina, Yndyra të Mira dhe Karbohidrate

Ideja për të ngrënë vetëm proteina dhe yndyra të mira, duke iu shmangur shumicës së brumërave, pemëve dhe perimeve mund të ju ndihmojë në humbjen e shpejtë të peshës, por në periudhë më të gjatë kjo formë e dietës nuk është e mirë as për trupin e as për trurin tuaj. Gjëja më e mirë që e preferojnë edhe dietologët më të njohur në botë është balancimi i proteinave, yndyrësve të mira dhe karbohidrateve. Të hash proteina në çdo vakt të ushqimit të ndihmon në balancimin e sheqerit në gjak. Prandaj në çdo vakt të ushqimit përpiku të hash proteina, karbohidrate me përmbajtje të lartë të fibrës dhe yndyra.

Si ndikon përmbajtja e hekurit në ushqim në sjelljet e fëmijëve

Metalet dhe elementë të tjera mund të jenë prezent në ushqim qoftë në mënyrë natyrale, ose nga veprimet direkte të njeriut. Për një kohë të gjatë është e ditur se sasi të mëdha të hekurit të pranishme në ushqim mund të jenë të dëmshme, por nuk ka mbështetje të fortë se disa elemente përcjellëse mund të kontribuojnë në sjellje agresive në shoqëri thotë Nevil Ward, profesor i kimisë në Universitetin e Surejit në Britani të Madhe.

Disa metale dhe elemente të tjera (Magnezi, Zinku dhe Bakri) mund të reagojnë si elemente ushqyese dhe janë esenciale për shëndetin, përderisa elementet tjera si Mercuri, Arseniku, Kadmiumi dhe Plumbi nuk kanë përfitime shëndetësore, madje njihet fare mirë ndikimi përkeqësues i mërkurit në qelizat e trurit.

Këto elemente që nuk janë elemente ushqyese jo vetëm që mund të jenë helmuese në sistemin shëndetësor, por ato mund të pengojnë absorbimin e materieve ushqyese në trup, të cilat në veçanti tek fëmijët ndikojnë në zhvillimin e sjelljeve agresive.



Gjërat që duhet t'i dimë rreth CELULITIT

1. Celuliti është thjesht trashësi

Celuliti është në të shumtën e rasteve trashësi e dëmtuar dhe është rezultat i lëvizjes së pakët dhe i tharjës së lëkurës. Dr. Elizabet Danci, autore e librit "Zgjidhjet për celulitin", thotë se qelizat yndyrore të femrave janë më të lidhura mes vete se sa tek meshkujt. "Prandaj kontrolloni peshën tuaj dhe mos u bëni rob i krevatit apo karriges"

2. Celuliti është trashëguese

E vërtetë. Si disa sëmundje tjera që mund të jenë trashëguese, e njëjta është edhe me celulitin. Mirëpo hormonet, dieta dhe stili i jetesës luajnë një rol të rëndësishëm. Pra nëse nëna apo gjyshja juaj kanë pasur këtë problem kjo nuk do të thotë që do ta keni edhe ju por vetëm nëse i përmbaheni rregullave. Prandaj sa më herët që filloni të përkujdeseni për veten aq më mirë.

3. Të kesh celulit do të thotë të jesh mbipeshë.

Kjo është një prej miteve më të dëgjua, e cila mund të jetë frustruese për ata njerëz,

të cilët janë mbipeshë. Mbi 80% e femrave kanë celulit deri në një masë kjo përfshinë edhe njerëzit e dobët e bile edhe modelet. Prandaj përkujdesuni për peshën tuaj, por mos provoni të dobësoheni më shumë përshkak të humbjes së celulitit sepse mund të mos ketë efekt.

4. Bëhet edhe më keq me plakjen?

Për fat të keq për shumicën prej neve kjo është e vërtetë. Celuliti fillon të formohet në kohën kur niveli i estrogenit fillon të rritet në pubertet dhe duhet përkujtuar se është devijim trupor që paraqitet me kohë. Me kalimin e viteve ne fillojmë të bëhemi më pak aktiv, shtojmë në peshë dhe lëkura fillon të lëshohet. Për ta parandaluar këtë është mirë që të ndërpritet konsumi i shkaktarëve kryesorë si duhani, alkooli dhe kafeja.

5 Pirja e ujit përmirëson celulitin?


Gabim. Megjithatë është mirë që të konsumohen së bashku 1.5 litër në ditë ujë me qëllim të përmirësimit të kushteve shëndetësore, përndryshe uji në celulit nuk ka ndikim.

6. Ushtrimet zbusin celulitin?

E vërtetë. Edhe atletët kanë celulit. Por me ushtrime largohen toksinet, mundësohet qarkullimi i gjakut dhe kjo ndihmonë në dukje sa më të butë të lëkurës sonë megjithë praninë e celulitit.

7. Një dietë e shëndoshë mund ta parandalojë celulitin

Jo edhe aq. Natyrisht një dietë e shëndoshë është gjithmonë një ide e mirë, por nuk nënkupton që ju nuk do të keni celulit. Është mirë që të konsumoni sa më shumë pemë dhe perime si dhe vaj të peshkut, duke ju shmangur ushqimit kalorik dhe me përbërje artificiale të sheqerit.



MENOPAUAZA

si t'a njohim

Nuk ka shpëtim prej saj.

Menopauza është një ndryshim normal në jetë dhe secila femër do ta përjetojë. Dr. S. Dragosha tregon simptomat e saj.

Secila grua reagon ndaj menopauzës në mënyra të ndryshme, prandaj ju duhet ta dini se çfarë ju pret në mënyrë që ta ndihmoni veten për të qenë të shëndetshme dhe të lumtura, dhe ta dini se çfarë trajtimi ju duhet dhe nga cilat ndryshime në stilin tuaj të jetesës mund të përfitoni. Menopauza nuk është diçka nga e cila duhet të keni frikë-disa femra e presin me druajtje, disa të tjera e shohin se një fazë të re në jetë qoftë emocionale, fizike, seksuale dhe spirituale.

Çfarë është menopauza?

Përkufizimi preciz i menopauzës është koha kur cikli menstrual ndalet përgjithmonë, e njohur si mungesë e menstruacioneve për 12 muaj. Kjo ndodh tek shumica e femrave midis moshës 40 dhe 58 vjeçare. Pak femra e arrijnë menopauzën në moshë 30 vjeçare dhe një numër më i vogël në moshën 60 vjeçare.

Çfarë do të ndodhë me mua?

Ka shumë faktorë që ndikojnë në menopauzën e një femre, kjo varet edhe nga individualiteti i femrës. Faktorët që ndikojnë në një menopauzë të hershme përfshijnë, moslindjen e fëmijëve dhe nëse jeni duhanpirëse, kjo shkakton hyrjen në fazë të menopauzës së hershme për dy vite më herët. Shërimi nga kanceri, kemioterapia po ashtu mund të sjellin menopauzë të hershme. Menopauza, është faza tek e cila gratë ndjehen të rëna shpirtërisht dhe fizikisht, nuk ndjehen të sigurta në vetvete dhe ju duket sikur kanë humbur feminilitetin dhe çdo gjë të bukur që lidhej me to.

Shoqërimi i menopauzës me ndryshime në jetën e tyre hormonale, shpirtërore është i rezikshëm nëse këto gra nuk kanë ambient apo familjaritet shumë të ngrohtë duke filluar me bashkëshortët e tyre e më pas fëmijët e deri tek kolegët. Asaj duhet t'i qëndrojnë pranë, t'i dhurojnë dashuri e vëmendje çdo detaji të kësaj kohe të vështirë për to. Edhe pse është proces apo fenomen shndetësor natyral, menopauza është periudhë më shumë problematike, irrituese se sa e lehtëkalueshme, prandaj ju duhet tu qëndrojmë pranë nënave, motrave tona që kjo kohë "e ngakuar" të mos lëndojë tek ata apo të ketë agravime më të mëdha, por të ikë shpejt e ti lerë vëndin një jete të qetë e të këndshme.

Fjala hyjnore

Fjala» bëhu»e Zotit tonë,
krijoj çdo gjë, qiell e tokë,
Dhe krijesat kudo në botë.

Fjala” bëhu”e Allahut tonë,
Natyren të bukur e krijoi ,
Si Libër të hapur e shikojmë.

Malet I përulen ,toka I bindet
Dielli për Të lind e perëndon
Hëna natën për të gjithë vezullon.

Fjala hyjnore dhe e vërtetë,
Me dëshirë i bindem në jetë
Zotit të mëshirshëm dhe të shtrenjtë

Fjala hyjnore dhe e vërtetë,
Rrezatuese në këtë jetë ,
Është fjalë e Zotit të shenjtë

Fjalë si burim i pashtershëm ,
Udhëzimi, Qortimi dhe Këshillimi
për zemrat tona, fjalë shpëtimi.

Fjala e shenjtë dhe e drejtë,
na ndriçon zemrër përjetë ,
Në këtë botë dhe në ahiret.

Fjalë që rreze sjell në jetë,
Është e bukur dhe e vërtetë,
Fjala e Zotit tonë të shtrenjtë.

Fjalë që largon mërzinë,
mbjell në shpirt qetësinë,
është ilaç për njerëzinë .

Fjalë që mbjellë gëzim,
Dhe shpresë për shërim ,
Është fjalë e Zotit tim.

Fjalë që jep vetëm lumturi,
Dhe shpresë për shpëtim,
Është fjala hyjnore e Zotit tim.

Fjala që shkëlqen e vezullon,
Nurë mbi nurë ajo qëndron,
Fjala e Zotit ,Kuran i jonë.

Nga Hava Surreli

